



RAPORT TREMUJOR I PUNËS

KOMUNA RAHOVEC

Zyra e Kryetarit Adresa: Rr. 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n,21000, Rahovec –Kosovës Tel :0382004534



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAČ / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNESË / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 296 Nr. i faq./Br.str./No.pg 194
Data/Datum/Date 12 / 04 / 2021
RAHOVEC / ORAHOVAČ

PËRMBAJTJA

KRYETARI I KOMUNËS	2
PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS	2
VIZIONI	3
PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2021	3
SYNIME PËR VITIN 2021	4
SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2021	5
Zyra Ligjore	6
Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit	7
Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura	8
Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun	11
Zyra e Auditimit të Brendshëm	12
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim	13
Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut	13
Zyra për Integritet Evropian	13
Zyra për Barazi Gjinore	14
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË	14
DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET	16
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE	19
DREJTORIA PËR ARSIM	20
DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM	22
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	25
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE	26
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	29
DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË	31
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	33
DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE	38
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	40
PËRFUNDIM	42

KRYETARI I KOMUNËS

ZOTIMI IM NË FILLIM TË MANDATIT

"Unë jam zotuar para qytetarëve të komunës së Rahovecit që me programin tim do të punojë për të gjithë. Unë kam platformën time qeverisëse dhe kjo platformë është në shërbim të të gjithë qytetarëve". SMYJL LATIFI

PRIONITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

Shitokë prioritetet e para strategjike janë të përqendruara nga jashtë dhe janë:

- **EKONOMI MË I FORTË KONKURRUES, QË JU JEP MUNDËSINË TË SHITËVE**
- **NË MIBES MË I FORTË, I QILIBËR DHE MË I SIGURT, DUKË REKUZAR NË KOMUNË TË QËNDROESHME PËR QËNDRATAT E ARDHSHME**
- **BUQËSITË AVANCUAR DHE TË ZHVILLUAR,**
- **EDUKIM, ARSIMIM DHE SHËRBIME TË QILIBËR QË LANË PËR QYTETARËT YANË,**
- **PËRMIRËSIMI I SHËNDËTTIT DHE MIBËQENIES, DUKË JU MUNDËSUAR BANOHËVE QASJE NË NË NËMËR MË TË MADH TË OBIKTIVE SHËNDËTËSORE DHE SHËRBIME NËPËR QËNDRA, DUKË JU SIGURUAR QË QYTETARËT YANË TË JENË TË MERKUTUR,**
- **PËRMIRËSIMI I QILIBËRIT TË TË RRINAVE DHE TË RRITURAVE,**
- **ADMINISTRATË LOKALE MËRTHIVE, QË OPRON SHËRBIME MUEKURE PËRSONIALE TË LIDHURA ME NË PROGRAM TË INVESTIMIT I LAZUAR NË NEVOJAT E QYTETARËVE.**

Fjala hyrëse

Qytetarë të komunës së Rahovecit,

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale 2021, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin tremujor për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën: janar – mars 2021.

Raporti pasqyron të gjitha aktivitetet dhe angazhimet e drejtorive komunale në Komunën e Rahovecit si dhe njërive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

Ky raport gjithpërfshirës ka për qëllim të nënvizojë, progresin e arritur në realizimin e prioriteteve të Komunës, në këtë aspekt ky raport ka si pikë reference Programin e Qeverisë Komunale.

Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale, dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të avancuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë Komunale, ky raport tremujor është mjet i komunikimit i të arriturave të pushtetit lokal, përkushtimit, angazhimit dhe vendosmërisë së treguar, në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Rahovecit.

VIZIONI

"Buqësi e zhvilluar, infrastrukturë të megulluar, përmirësim i shëndetit dhe mirëqenies sociale, edukim, orshim dhe shërbime të cilësia së lartë për qytetarët tanë, krijimi i kushteve më të mira për investime në ekonomi, krijimi i hapësirave nga menoxhimi i APK (Agjencioni Pyetar i Kosovës) në menoxhim nga Komuna"

VLERAT TONA:

Kemi një grup të përbashkët të vlerave thelbësore që formësojnë mënyrën se si do të merremi me klientët, partnerët dhe kolegët. Duam të sigurohemi që çdo gjë që bëjmë dhe shërbimet që ne ofrojmë do të jenë të duhura për njerëzit që kanë nevojë për to dhe ne do të përpiqemi ta bëjmë me:

- **Transparencë:** të qenit të hapur dhe të ndershëm;
- **Përgjegjëshmëri:** duke marrë përgjegjësi me vullnet të lirë dhe dëshirë;
- **Drejteshi:** ne ofrojmë diversitetin dhe promovojmë barazirë;
- **Partneritet:** puna me komunitete, biznese dhe partnerë të tjerë.

Në vazhden e zbatimit të vizionit për Rahovecin që është bazament i qeverisjes së tanishme lokale, prioritetet kryesore për vitin 2021 janë këto:

PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2021

- **RAHOVECI NË VEND I DËSHIRUESHËM PËR TË JETUAR, PËR TË FUNDUAR DHE PËR TË MBATUR FAMILJEN,**
- **TË FËRQECUESHËM NGAJ NEVOJAVE TË QYTETARËVE, NË RRITJEN E NIVELIT TË KËNAQSHMËRISË SË QYTETARËVE ME QËRIMIN E SHËRBIMEVE DHE INFORMIM PUBLIK QILËSOR,**
- **KOMUNË ME PËRQËNDRIM TË MIRË DHE QEVERISJE DEMOKRATIKE,**
- **ADMINISTRATË EFKASË, E FËRQECUESHME DHE ME SHËRBIME MODERNE,**
- **QEVERISJE ENERJTIKE, VËRRJESË DHE VENDIMMARRJE PA VONISË,**
- **REALIZIM I SUKSESHËM I REKURITIVËVE DHE I BUXHETIT,**

- REALIZIMI I PLANIT TË TË HYRAVE KOMUNALE,
- PROMOVIMI DHE PËRMIRËSIMI I MËDHSIT TË BASHKËSISË SI QYTET UJER PËR USHTRIMIN E VERIFIKUARIN E TË BASHKËSISË ERZISTUES, ZGJERIMIN E TYRE SI DHE PËR ALO TË REJAT,
- NDËRTIMI I BRUGËVE TË REJA DHE MIRËMBALTA I BRUGËVE ERZISTUES,
- RRËZJA I RONT DHE SHITIMI I AKTIVITETEVE TË INSPIRATORIA,
- EDUKIM TË DOKTORIT I ERZAVE TË NINË DURE IU OFROAR MËSIMORËNI DHE MËSIMORËNI QËSORE BASHKËKOHORE, MËDHSIT TË PËRSHITASHËM MËSIMOR ME INFRASTRUKTURË ADEKUATE DHE QUTËPËRSHITËSË,
- QUTËPËRSHITËSË TË MËDHSITËVE PËR RENEKACION, KOZARUVE KULTURORE DHE PROGRAMI PËR TË PËRMBUSHUR NEVOJAT E QYTETARËVE TË TË QUTËA MËSHAVE, ME TËRKS TË VECANË NË MIRËMBALTA I NINËT,
- KRUIMI DHE MIRËMBALTA I SISTEMI TË SIGURITË DHE TËRKS TË QARKULLIMIT NË TRAFIK,
- SHITIMI DHE MIRËMBALTA I PARKUVE, PAFËSIRAVE PUBLIKE, QUTËRIVE REKREATIVE, BRUGËVE, NDËRTESAVE DHE INFRASTRUKTURËS TËTËR ME QËLLIM TË ARRITJES SË STANDARDEVE TË LARTA TË DUKES DHE QUTËRIS SË TËRË,
- VIZITA SISTEMATIKE SHËNDETËSORE NËPËR TË QUTËA SHKOLLAT,
- NËRTJE TË INVESTIMIVE DHE PROJEKTEVE NË TUNIZËM,
- TËRQVARE DHE SHITJE TË ECOS PËR RËMBËSORË E HICKUSIT,
- RRËZJE E PËRERRATJES PËR BUQËSINË DHE RRËZJE E PËRERRATJES DËRREKTË PËR ERZIMËRËT,
- PROJEKTE PËR KRUIMIN E TOKAVE BUQËSORE,
- RRËZJE E QËSISË DHE INVESTIME NË AGRIM,
- BURSA PËR STUDENT,
- BASHKËPUNIM I MIRË ME DONATORËT E JASHTËM,
- KOMUNIKIM DHE BASHKËPUNIM ME OIQ-TË,

SYNIME PËR VITIN 2021

- RIPARIMI DHE MIRËMBALTA I BRUGËVE FUSHORE,
- INTERVENIMI NË NDËRTIMIN E KANALEVE TË KULLIMIT DHE DRENAZHIMIT TË TOKAVE BUQËSORE,
- ZGJERIMI I SISTEMI TË UJITËS NË FUSËT KU MURGOR,
- PASTRIMI DHE MIRËMBALTA I PËRKOQAVE, SI DHE KRUIMI I ERZEVE MOBILE TË PËRANIMIT TË APLIKACIONEVE PËR FACESA DËRREKTË NË BY QUTËRAT MË TË MËDHSITË KOMUNËS SONË,
- FUNKSIONALIZIMI I FLOTË ERZEVE PËR PARANDALIMIN DHE REAGIMIN KUNDËR ERZATJES DHE MËSHKËRSHIMIT TË NËRTËSIVE (EPHEM) NËPËR SHKOLLAT,
- FUNKSIONALIZIMI I FLOTË I AKTIVAVE PROFESIONALE (AP) NË SECILËN SHKOLLË,
- RIPARIMET DHE INVESTIMET NË ERZIMËRËT TË ERZIMËRËT NË QUTËRAT SHKOLLORË,
- PËRMBUSHURIN I INVESTIMIVE TË PLANIFIKUARA NË NDËRTIMIN E QËRËRIVE PËR HËMUË,
- PËRMBUSHURIN I PROJEKTEVE PËR NDËRTIMIN E SHKOLLAVE TË REJA TË FILLUARA NGA VITI 2018 DHE 2019,
- HARTIMIN E PROJEKTI KRYESOR TË SHËSHIT QËNDORË TË BASHKËSISË DHE NËRTJEN E PUNIMEVE NË RËTË PROJEKT, ERZIMËRËT E TË HYRAVE VETANAKE PËR MËS LËSHIMIT TË LËTËVE NDËRTIMORË, PROCESIT TË LEGALIZIMIT DHE LËTËVE MËDHSITËRE KOMUNALE, NË BASHKËPUNIM ME DËRËTORINË PËR PUNË INSPIRATORIA, LEGALIZIMIN E QUTËRIVE PA LËTË DHE RESPEKTIMIN E LËGRT TË RI PËR TRAFIKUNIN E QËRËRIVE FALJE,
- VËRËMBUSHURIN E TRAFIKUNIN TË SHËRËTËRIVE TË LUMËRIVE DHE PËRERRATJES, PËR MËS INVESTIMIVE KAPITALE NGA KOMUNA E BASHKËSISË DHE MËRËSHITËSË NGA QËVËRJA E KOSOVËS, ME QËLLIM MËRËMBUSHURIN NGA

VËRSHIMET DHE RUATJEN E MUESIT, MENIMI I HAPËSRAVE TË REJA TË GJELHËRUARA, RREGULLIMIN E PAKOJVE DHE MRELLJENË DHRUNVE

- TRAJTIMI I UJËRAVE ATMOSFERIK NË QYTET,
- INFRASTRUKTURA PUBLIKE NË KRJETIN E KANALIZIMEVE PEKALE DHE GRUPAVE SËPTIKË, ZGJERIMET
- NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE, NDRICIMI PUBLIK, TROTUARËT DHE MIRËMBALJA E HAPËSRAVE PUBLIKE
- FUNKSIONALITETI MË I MAFH I BHETIT TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORI DHE KOPËZGJATI E SHËRBIMEVE
- VAZHDIMI I TRAJTIMIT TË SHËRBËRIVE TË LUMENAVE DHE HËRRENAVE, PËRMES INVESTIMEVE KAPITALE NGA
- INVESTIMI NË TRAJTËCIMI KULTURORE DHE HISTORIK, RESTAURIMI, NDËRTIMI I MUZEVE ETJ.
- PLANI I VEPRIMIT PËR BHETIN E TË HYRAVE KOMUNALE;
- PLANI I VEPRIMIT PËR INKASIMIN E VATIMIT NË TOKË;
- SUBVENCONIM MË I MAFH I OJQ-VE, KATEGORIVE TË CARTVARA TË SHCOËRISË DHE I VEPRIMTARIVE TË NDRYSHME KOMUNALE
- MENËCOVINE AKTIVE DHE BHETË E QJËSISË NË INVESTIMET PUBLIKE;
- VAZHDIMI I EVIDENCIMIT DHE LIRIMIT TË PRONAVE TË UZURPUARA NË NIVEL TË KOMUNËS;
- BYNSHIMI I HËRSHKËTIVE PËR MËRQUTË TË MUESIT, MËRQUTËN E TOKAVE BULOËSORË, MËRQUTËN E PRONËS PUBLIKE, PARANDAJIMI I NDËRTIMEVE PA UJË;
- PLANIFIKIMI I MASAVE PËR MËRQUTË, SHËRËM DHE NDRIMË NË BAST TË PATRËDËSIVE NATYKORE DHE PATRËDËSIVE TË TËRKA;
- PROJEKTI ME PARTNERITET PUBLIKO-PRIVAT;
- HARTIMI I PLANIVE, NDRËRJA E AKTIVE DHE RREGULLOJVE TË TËRKA TË PUNËS;
- ZHVILLIMI I BARROVËCIT NË PËRPUTHJE ME PLANET ZHVILLIMORE KOMUNALE DHE MËNAXHIMI I BURIMEVE NATËRE PAZUAR MEI PARIMET E SHËNDOSHA MUESITËSORË SI DHE MEI PARIMET E PARTNERITETIT ME MËKANIZMA VENDORË E NDRËKOMBËTAS, TË QJËT NDRIMORË NË ARRITJEN E VIZIONIT PËR KOMUNË MODËR ME NJË QEVERISJE KUALITATIVE, HIRASE DHE LLOGARIDHËNËSË;

SHIDAT KRYESORE PËR VITIN 2021

- BUXHETI I QJËT I QEVERISË SË KOSOVËS, MUNGESA E MUESITËVE TË MAFHTUESHME FINANCIARE NGA QEVERIA QENDRORE SI TRËND I VAZHDUESHËM NË KOSOVË, QË I HËR INVESTIMET EDHE MË TË VËSHITËSA (ANGAZHIME TË SHTUARA NË RËRHISA NGA QEVERIA QENDRORE).
- INTËGRIMI I SA MË SHUMË QYTETARËVE DHE TRËNDIMI I BASHKËRËPUNIMIT TË NGUSHTË ME ORGANIZATAT JOQEVERITARE (OJQ-TË), HIRNËSËT, ZANATLINDËT, TREGTARËT, BUCIT, SHCOËRINË CIVILE ETJ.
- MUNGESA E HAPËSRAVE PUBLIKE NË QJËTË TËRRITONINË KOMUNËS SË BARROVËCIT
- MUNGESA E BURIMEVE TË MAFHTUESHME NDRËZORË DHE PROFESIONALE
- PËRSHIRJA MË I MAFHE E QYTETARËVE JANË NË AKTIVITËTET TËRKA DHE DUKE I MAFHTUR AJA TË INFORMUAR PËR TË QJËTË KËTO ZHVILLIME

Zyra Ligjore

Fushëveprimtaria e Zyrës Ligjore

- Zyra Ligjore ofron ndihmë juridike, shërbime dhe këshillime për drejtori, zyra dhe sektorë, institucionet dhe ndërmarrjet komunale;
- Shqyrton të gjitha projekt-rregulloret që propozuesit ia dërgojnë për miratim Komiteteve kompetente dhe Kuvendit të Komunës, duke garantuar pajtueshmëri me ligjet ekzistuese në fuqi dhe Statutin e Komunës;
- Harton (përpilon) vendime, aktvendime, pëlqime, urdhëresa, memorandume mirëkuptimi, kontrata, marrëveshje, leje pune, leje ndërtimi dhe shkresa të tjera për organet komunale dhe trupat e formuar nga organet komunale.
- Shqyrton propozimet e rregulloreve dhe akteve të tjera që i propozohen Kuvendit të Komunës për miratim, përgatit dhe harton rregulloret dhe urdhëresat administrative që i lëshon Kryetari i Komunës;
- Merr pjesë në komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështjet e caktuara, merr pjesë në të gjitha seancat e Kuvendit Komunal dhe komiteteve të formuara nga Kuvendi i Komunës, Zyra si strukturë organizative kryen edhe punë të tjera që i caktohen me ligj, Statutin e Komunës dhe rregulloret e tjera në fuqi.

Objektivat e arritura:

Në periudhën janar- mars 2021, Sektori Ligjor në Komunën e Rahovecit ka arritur këto objektiva:

Rregullore	2
Plotësim dhe Ndryshim i Rregulloreve	1
Vendime për Kryetarin	140
Vendime për Kuvend	14
Urdhëresa	20
Autorizime	0
Kërkesa	0
Opinione Ligjore	0
Marrëveshje	2
Propozime për Kuvend	10
Akte përcjellëse	7
Kontrata	0
Konsultime	permanente
Përgjigje në kërkesë	6
Njoftime	0
Deklarata	0
Puna në Komisione	9
Totali i akteve të hartuara për periudhën janar-mars 2021 nga Sektori Ligjor është:	211

Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

Rekrutimet

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur 14 konkurse publike në shërbimin civil.

Pushimet vjetore

Pandemia COVID 19, ka pamundësuar që punonjësit e administratës komunale të shfrytëzojnë pushimet vjetore, kjo pasi një kohë stafi nuk ka punuar.

Lëshimi i akteve administrative

Njësia e Personelit gjatë kësaj kohe ka hartuar 55 shkresa të ndryshme administrative.

Tabelat statistikore

Të dhënat statistikore të personelit, Njësia e Personelit i procedon drejtpërdrejtë në programin elektronik SIMBNJ, sipas kërkesës së MAP/DASHC-së, që bëhet rregullisht. Njësia e Personelit të dhënat statistikore për sektorët e arsimit dhe shëndetësisë i siguron nga zyrtarët e atyre dy sektorëve.

Komisioni Disiplinor

Në Komisionin disiplinor gjatë kësaj periudhe kemi pasur vetëm një rast për ndjekje disiplinore.

Vijueshmëria e punëtorëve në punë

Funksionon Sistemi i Mbikëqyrjes së Vijueshmërisë së punëtorëve në punë-SMVP, u janë dërguar drejtorive raportet e vijueshmërisë së punëtorëve për çdo muaj dhe atë për janar, shkurt dhe mars 2021.

Plani individual i personelit

Njësia e personelit ka hartuar Planin Individual të Personelit të Komunës së Rahovecit për vitin 2021 dhe është hartuar në mënyrë elektronike sipas programit SIMBNJ.

Administrimi i programeve elektronike

Njësia e Personelit menaxhon dhe monitoron disa programe elektronike që kanë të bëjnë me burimet njerëzore si në vijim:

- Menaxhon me programin elektronik SIMBNJ që dmth. Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
- Monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punët të punëtorëve, pra programin SMVP.
- Menaxhon (një pjesë) me programin SMAED që në nivel shtetëror është kompetent ASHI-Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit/MAP.
- Monitoron me programin elektronik PYROLL, pra programit të listave, pagave dhe pagesave të komunës

Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

Zyra për Përfaqësim Ligjor (ZPL) e Komunës së Rahovecit kryen detyrat dhe punët në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës, në bazë të praktikës së Avokaturës Publike Komunale dhe Ligjit për Avokaturën Shtetërore.

Regjistrat:

1. Regjistri për lëndë (procedure) civile "C";
2. Regjistri për lëndë (procedurë) përbarimore "P";
3. Regjistri për lëndë (procedurë) administrative dhe konfliktet administrative "KA";
4. Regjistri për lëndë (procedurë) të ndryshme "CN";
5. Regjistri për lëndë (procedurë) at-hezionit "PA" dhe
6. Regjistri për lëndë të brendshme administrative "ZPL".

Pasqyra tabelare (si më poshtë) për të gjithë Regjistrat, paraqet lëndë në punë, të pranuar, të kryera, të pakryera dhe lëndë të mbetura si dhe pasqyra për aktivitetet e ndërmarra.

PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE

	Sipas Regjistrave të ZPL	Civile	Përbarimore	Konflikt Administrativ	CN Ndryshme	Proc.At_Hezionit	Avokatura	Gjithsej punë të kryera
1	Lëndë të pa zgjidhura-të bartura	935	112	10	32	14	34	1137
2	Lëndë të pranuar	129	74	1	0	0	2	206
3	Të gjitha lëndë në punë	1064	186	11	32	14	36	1343
4	Lëndë të zgjidhura	11	8	0	0	0	17	31
5	Lëndë të mbetura	1053	183	11	32	14	19	1312

LËNDË TË REJA TË PRANUARA GJATË VITIT 2021:

PADI TË REJA SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE

	Lëndë të reja të pranuar gjatë periudhës raportuese	Civile	Përmbaramore	Konflikte Administrative	Civile Ndryshme	Proc.AE_Hezionit	Avokatura Ndryshme	Gjithsej punë të kryera:
1	Vërtetim i pronësisë	1						1
2	Kompensimet sipas kontratës kolektive	126	72					198
3	Kompensim i pagës shtesë	2						2
4	Lëndë të tjera	0	2				2	4
	Gjithsej:	129	74	0	0	0	2	205

PASQYRA E AKTIVITETEVE SIPAS REGJISTRAVE PËR PERIUDHËN RAPORTUESE:

PARASHTRESA TË PRANUARA	CIVILE	PËRMBARIMORE	KONFLIKTE ADMINISTRATIVE	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Deperamenti Ekonomik	GJITHSEJ
Aktvendim+Aktgjykim I	23	0	0	0	0		23
Aktvendim+Aktgjykim II	7	0	0	0			7
Aktvendim+Aktgjykim III	0		0	0			0
Aktgjykim+Aktvendim DHPGJS	0						0
Urdhër përmbarimor		71					71
Aktvendim E për lejimin e përmbarimit		1					1
Aktvendim për 180 ditë	0						0
Padi me prova	129		0	0			129

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

Aktvendim për përgjigje në padi	134		0	0			134
Përgjigje në ankesë C	3		0	0			3
Përgjigje në ankesë P		0					0
Përgjigje në prapësim		0					0
Përgjigje në revizion	0						0
Përgjigje në propozim për ML	1						
Precizimi i padisë	7		0				7
Prapësim i debitorit		0					0
Ankesë C e paditësit	1						1
Ankesë P e kreditorit		0					0
Revizion C i paditësit	0			0			
Ekspertizat	2			0			2
Aktakuzë					0		0
Parashtresat tjera	0	0		0			0
	307	72	0	0	0	0	378

Të gjitha shkresat e panuara janë sistemuar nëpër lëndë përkatëse dhe është vepruar në interes të Komunës varësisht nga rasti. Vendimet të pranuara gjyqësore të shkallës së parë, të dytë dhe të tretë pas analizimit të tyre, ato të cilat kanë qenë në dëm të Komunës janë kontestuar në shkallë tjetër gjyqësore.

PARASHTRESA TË DËRGUARA	CIVILE	PËRMBARIMORE	KONFLIKTE ADMINISTRATIVE	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Deperatamenti Ekonomik	GJITHSEJ
Ankesat	14	0	0	0	0		14
Përgjigje në ankesë	0		0	0			0
Përgjigje në padi	14		0	0			14
Mbrojtje në padi DHP GJS	0						0
Revizion	0						0
Përgjigje në revizion	0		0				0
Propozim për ML	0		0				0
Përgjigje në ML	0						0
Prapësimet		70					70
Përgjigje në prapësim		0					0
Ushtrimi i padisë	0						0
Kundërpadi	1						0
Kallëzim Penal					0		0

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

Ushtrimi i propoz. për përmbarim		0					0
Parashtrësata tjera	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej:	23	70	0	0	0	0	92

Seancat e caktuara nga kontestet civile, përmbarimore, etj. nga gjykatat për periudhën raportuese.

Për të gjitha lëndë aktive, gjykatat kanë caktuar dhe janë mbajtur seancat gjyqësore në të cilat Komuna është e paditur ose paditëse, si në vijim:

Seancat gjyqësore gjatë vitit 2019	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Nr. i seanceve të mbajtura:	13	11	10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	34
Sipas kontesteve:													
Civile	34												
Përmbarimore	0												
Konflikte Administrative	0												
Civile Ndryshme	0												
Proc.At. hezionit	0												
Gjithsej:	34												

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në Komunën e Rahovecit, është angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale.

Lajmet, njoftimet dhe dokumentet tjera që kanë të bëjnë me Zyrën e Kryetarit, Kryesuesit dhe drejtorive komunale, janë publikuar në uebfaqe dhe të njëjtat janë dërguar për publikim në portalet lokale gjithashtu edhe në ato nacionale, është përgatitur plani për dokumentet komunale që do të kalojnë procedurat e debateve dhe konsultimeve publike, i njëjti është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës, poashtu është përgatitur regjistri për evidencën e kërkesave të pranuar dhe përgjigjeve të dhëna për Qasje në Dokumentet Publike të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në ligin për QDP Nr. 06L-081.

Poashtu, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun ka përcjellur të gjitha seancat e Kuvendit Komunal, për të cilat me kohë janë njoftuar edhe gazetarët, gjithashtu, ka përcjellur edhe të gjitha mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë publikuar vendimet e nënshkuara të kryetarit në uebfaqe zyrtare. Në vazhdimësi vendimet e nënshkuara nga Kryetari janë dërguar tek zyrtari përgjegjës për pranimin e vendimeve në MAPL.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë përgatitur 44 lajme, 25 njoftime, 1 ftesë dhe 8 thirrje. Janë publikuar edhe 126 vendime të nënshkuara nga kryetari i komunës.

Muajt	Lajme	Njoftime	Ftesa	Thirrje	Vendime	Konkurse	Ankande	Debate/ Konsultime	Kërkesa QDP	Aktivitete për muaj
1.Janar	9	15	0	2	12	22	0	3	3	66
2.Shkurt	21	4	0	1	26	9	0	0	5	66
3.Mars	20	6	1	5	88	3	2	0	0	125

Zyra e Auditimit të Brendshëm

Në kuadër të këtij tremujori, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin Vjetor të Punës për vitin 2021, i cili plan ka qenë i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa, bazë ligjore ka pasur Ligjin për Auditim të Brendshëm (LAB), Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

- Në muajin janar, angazhimet tona kryesisht kanë qenë në verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të AB dhe Auditorit të Përgjithshëm të dhëna në auditimet e kaluara, si dhe përgatitja e raportit të gjashtëmujorit të dytë dhe raportin vjetor të NJAB-së për vitin 2020.
- Në muajin shkurt është bërë verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në vitin 2020.
- Raporti i gjashtëmujorit të dytë dhe Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2020 i janë dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), Kryetarit të Komunës dhe Komisionit për Auditim të Brendshëm, të gjitha janë dorëzuar brenda afatit kohor të paraparë me ligj.
- Si aktivitete tjera mund të cekën edhe ofrimi i ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha drejtoritë komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë, lidhur me të kuptuarit e rreziqeve në implementimin e rekomandimeve, identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e tyre, duke krijuar një regjistër me rreziqe të identifikuarashtu që menaxhmentet gjegjëse të kenë më lehtë të ushtrojnë kontrollet gjegjëse adekuate për minimizimin e çdo rreziku që mund të jetë pengesë për zbatimin e objektivave të drejtorive.
- Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Brenda tremujorit të parë të vitit 2021, ZKK ka kryer rregullisht punët e saj në fushëveprimin që i takon.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

- Në kuadër të koordinimit dhe implementimit të aktiviteteve në bazë të planit vjetor të ZKKK-së, janë realizuar 12 takime të rregullta me stafin e ZKK-së;
- ZKKK në bashkëpunim me IOM, ka realizuar ndarjen e granteve për stabilizimin e komuniteteve për 1 pjestarë të komunitetit Serb dhe 1 pjesëtar të komunitetit Egjiptian
- Nënshkrimi i marrëveshjes IOM- Komunë (në rrethimin e varrezave të komuniteteve në fshatin Krushë e Madhe)
- Në kuadër të projektit "PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS NË VENDBANIMET E KOMUNITETEVE JO-SHUMICË NË KOMUNËN E RAHOVECIT" kanë vazhduar punimet e rrugës në fshatin Xërxë dhe fshatin Çifllak në kubëzimin e venbanimeve të komuniteteve;
- Janë mbështetur me dru zjarri, 3 familje nga komuniteti serb në fshatin Hoçë e Madhe dhe 1 familje nga komuniteti rom nga fshati Xërxë. Janë mbështetur me ushqim dhe mjete higjienike 3 familje të riadhesuara nga diaspora.

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut

Duke u bazuar në objektivat që i ka të planifikuara Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut për realizim të aktiviteteve gjatë gjithë vitit, NJKDNJ në tremujorin e parë të këtij viti për zbatim, monitorim dhe raportim mbi zbatimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi promovimin dhe përhapjen e vlerave në fushën e të drejtave të njeriut, e në veçanti të gruas si dhe fuqizimi, integrimi i saj në jetën shoqërore ka realizuar një sërë aktiviteteve.

Zyra për Integrimi Evropiane

Zyra për Integrimi Evropiane ka kryer funksionin dhe detyrat e veta, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011, për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për integrimi evropiane, në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamentin për Integrimi Evropiane.

Mbikëqyrja e aktiviteteve të drejtorive që burojnë nga PKZMSA-ja, si dhe dokumentet e tjera strategjike të MAPL-së dhe Qeverisë së Kosovës. Obligimet e komunave që dalin nga Agjenda Evropiane, duke u bazuar në Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit;

Procesi i ri- integrimin për personat e riadhesuar:

Ofrimi i shërbimeve sociale dhe familjare, monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të përbashkëta, banimi përmes qirasë, regjistrimi civil dhe pajisja me dokumente personale, përfshirja e të riatdhesuarve në përfitimet nga skemat sociale sipas legjislacionit në fuqi, verifikimin e rasteve në terren në bashkëpunim me koordinatorin regional dhe futja e të dhënave në SMR-në.

Zyra për Barazi Gjinore

Edhe pse në komunën tonë sfidë në vetvete mbetet implementimi i Ligjit për Barazi Gjinore dhe arritja e barazisë gjinore, falë mbështetjes komunale, organizatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare si dhe angazhimit të përbashkët të të gjithë aktereve por edhe i ZBGJ, kemi arritur të realizojmë një pjesë bukur të madhe të aktiviteteve të parapara për këtë periudhë tremujore njëherit të bazuara në Planin Vjetor të Punës për arritjen e barazisë gjinore.

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Raporti i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, në vazhdim pasqyron punën e kësaj Drejtorie për periudhën: janar - mars 2021, punë kjo e realizuar në përputhje me Statutin e Komunës, Planin e Punës, ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe vendimet në fuqi.

Qëllimi i këtij Raporti është informimi i drejtë i qytetarëve për nivelin e funksionimit, ofrimi i përshkrimit të standardizuar të punës dhe fushëveprimit, duke krijuar një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, për periudhën: janar - mars 2021.

Si një segment i rëndësishëm i Komunës, ku qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal po thuaj se çdo ditë, Administrata Komunale gjatë kësaj periudhe tremujore ka bërë përpjekje që të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, duke ju ofruar qytetarëve të saj, si në aspektin kohor dhe atë cilësor realizim të të drejtave të tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës, me kohë maksimale të pritjes 5 minuta, për të gjitha shërbimet që i ofron administrata. Në këtë drejtim fokusi ka qenë realizimi i synimeve programore, respektimi dhe zbatimi i ligjit si dhe akte të tjera juridike, të gjitha këto si parakushte për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, gjithmonë në shërbim të përmbushjes së kërkesave individuale dhe të përgjithshme të qytetarëve, pa asnjë dallim. Këto synime sipas planit tonë të punës, dukshëm kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së përgjegjësisë në punë, disiplinë në punë, respektim të orarit, avancim të metodës së punës, transparencë dhe efikasitet në punë.

Sektori i Gjendjes Civile

- Sektori për Gjendje Civile në tremujorin e parë të vitit 2021 ka realizuar punët bazuar në ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative mbi dokumentet dhe lëshimin e dokumenteve zyrtare.
- Ky sektor ka kryer veprime të shërbimit të gjendjes civile siç janë: plotësimi, përditësimi dhe administrimi i regjistrave të gjendjes civile, zhvillimi i procedurave administrative, mbajtja e akteve të gjendjes civile, lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile si dhe veprimeve tjera juridike administrative në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Sektori i Teknologjisë Informative

Sektori i Teknologjisë Informative ka vazhduar me zbatimin e planifikimit vjetor të punëve si dhe të përditshme siç janë: monitorimi i rrjetit, sistemeve, përkrahja e zyrtarëve etj.

- Gjatë periudhës janar – mars 2021 si fillim është bërë pastrimi i rregullt i serverëve, bartja e incizimeve nga kompjuteri i sallës së kuvendit në NAS,
- Kemi bërë testimin e disa kabllave prej burimit të pikave ndërlidhëse deri tek kompjuterët, printerët dhe pajisjet tjera,
- Kemi bërë instalimin e sistemit operativ ëindoës 10 në disa kompjutera ku kemi patur mundësi dhe paketën e office.
- Kemi pasur mjaft kërkesa për përkrahje Ad-Hoc, të cilave iu kemi përgjigjur nëpër zyrat e vendit (intervenim në kompjutera, përkrahja në krijimin e dokumenteve të ndryshme etj...).
- Po ashtu vazhdimisht kemi marrë me sistemin e intranetit dhe ku ka pasur nevojë të bëjmë edhe përkrahjen tek stafi që ka nevojë për shfrytëzimin e këtij sistemi
- Asistim në çdo takim që mbahet në sallën e kuvendit.
- Gjatë kësaj janë paraqitur disa defekte teknike në paisjet e rrjetës, të cilat i kemi eliminuar bashkarisht me asistencë të ASHI-së.

Sektori për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve

- Ndërmarrje e të gjitha masave të nevojshme për organizimin më të mirë të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, përgatitja e materiale të nevojshme, dërgimi i ftesave dhe çështje të tjera rreth organizimit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Organizimi i mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës (3 mbledhje) të Kuvendit Komunal;
- Organizimi i mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa;
- Dërgimi i të gjitha akteve në MAPL, sipas kërkesës së tyre;
- Përpilimi dhe lekturimi profesional të materialeve literare në gjuhët zyrtare në Komunën e Rahovecit.

Sektori për Mirëmbajtje, Logjistikë dhe Sigurim të objekteve

- Sektori për mirëmbajtje, logjistikë dhe sigurim të objekteve, brenda kompetencave ka kryer punët rutinore pa ndonjë specifikë, ky sektor është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbrim etj).
- Kemi menaxhuar me racionalitet të plotë dhe të domosdoshëm me fushën e logjistikës, ku përfshihet menaxhimi i automjeteve, titullar pronësore e të cilave është Komuna e Rahovecit, duke ushtruar në permanencë mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, servisimin, sigurimin dhe regjistrimin e tyre, furnizimin transparent me derivate etj.

Qendra për Shërbime me Qytetarë

Përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, për këtë periudhë raportuese është arritur ngritja e bashkëpunimit me të gjitha drejtoritë e administratës komunale, organet e komunës dhe njësitë e tjera për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/lëndëve brenda afateve ligjore.

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë – Sektorit Pritës – Protokoll, ka qenë mjaft efikase dhe funksionale në realizimin e lëndëve si të përfunduara – vendosura lëndët sipas kërkesave të qytetarëve me kohë dhe brenda afateve ligjore, d.m.th. të gjitha lëndët janë përfunduar sipas Ligjit të Procedurës Administrative, me çka mund të thuhet se shërbimi ndaj qytetarëve ka qenë në nivelin shumë të kënaqshëm. Gjithashtu nivel i kënaqshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve ka qenë edhe në drejtoritë e tjera të Administratës Komunale që me kohë kanë përfunduar – vendosur lëndët sipas kërkesave/parashtresave të qytetarëve.

Përfundim

Bazuar në punën e bërë gjatë periudhës (janar- mars 2021), konsiderojmë (vlerësojmë) se është bërë një hap suksesi në rrugëtimin tonë, për të arritur dhe synimet tona të përbashkëta. Rekomandimet dhe sugjerimet janë të mirë se ardhura.

DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

Drejtoria për Financa dhe Buxhet ka përgatitur raportin e punës për periudhën: (janar- mars 2021), i cili është një përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve të cilat janë kryer gjatë kësaj periudhe raportuese , bazuar në : Ligjet, udhëzimet administrative, rregulloret të cilat e rregullojnë fushën të cilën e mbulon DPF, bazuar edhe në programin e punës së Kryetarit të Komunës, planin e punës së drejtorisë, bazuar në planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit komunal, inkasimit të të hyrave vetanake, mbajtjen e lidhjeve dhe korrespondencave me ministritë e linjës e në veçanti me Ministrinë e Financave.

Më poshtë po paraqesim në vija të shkurtëra disa nga punët dhe aktivitetet më kryesore në sektorë të drejtorisë:

Sektori për Buxhet dhe Financa

Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë, ne si drejtori kemi kryer të gjitha detyrat dhe obligimet që i takojnë kësaj drejtorie.

Në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, kemi arritur që detyrat dhe obligimet që dalin para kësaj drejtorie të kryhen në afate ligjore duke evidentuar dhe regjistruar të gjitha të hyrat sipas kategorive të tyre, si dhe shpenzimin e Buxhetit të të gjitha kategorive.

Gjate kësaj periudhe raportuese kemi mbajtur takime të ndryshme me MF-në, Asociacionin e Komunave të Kosovës, organizata të ndryshme, apo donator takime këto në të cilat kryesisht janë trajtuar çështjet financiare.

Tek shpenzimet operative kemi arritur të kursejmë disa shpenzime kryesisht Mallra dhe shërbime pa e dëmtuar Buxhetin në kategori të tjera, duke i rritur disa shpenzime-shërbime të cilat në të kaluarën janë paguar nga kapitalet e realisht kanë qenë Mallra dhe Shërbime, siç janë : mirëmbajtja e ndërtesave dhe rrugëve, pastrimi i rrugëve, rrënimi i objekteve pa leje, sinjalizimi i rrugëve etj.

Gjithashtu kemi arritur që të kemi një inkasim të mirë të të hyrave vetanake, edhe përkundër situatës së krijuar nga paraqitja e pandemisë globale, përhapja e infeksionit COVID-19.

Në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, janë realizuar detyrat kryesore duke respektuar edhe afate liqjore të rregulluara me liqjet që rregullojnë financat publike.

Komuna e Rahovecit për vitin 2021 ka operuar me një Buxhet prej: 14,216,590.00 euro të përbërë nga Grandi Qeveritar dhe të Hyrat Vetanake:

Grandi i qeveritar	13,155,497.00€
Të hyrat vetanake	1,061.093 €
Gjithsej	14,216,590.00

Shpërndarja e buxhetit nëpër kategori ekonomike në vitin 2021 është siç vijon:

Paga e mëditje	7,622,634,00 €
Mallra dhe shërbime	1,715,477.00 €
Shpenzime komunal	280,500.00 €
Subvencione dhe transfere	311,000.00 €
Investime kapitale	4,021,979,00 €

Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi realizuar këto detyra:


- Zotime, pranime, shpenzime për Mallra dhe Shërbime ,shërbime komunale ,subvencione dhe transfere , dhe investime kapitale dhe përgatitja e ndryshimeve në listën e pagave për punëtorë;
- Përgatitja e raportit financiar në baza tremujore 2021 për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e Komunës;
- Raportimi i obligimeve financiare në baza mujore në Ministrinë e Financave;
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore(shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në Eëb faqen e Komunës;
- Përgatitja e dokumentacionit për bartjen e mjeteve nga viti 2020 për Kuvend, dhe Ministrinë e Financave;
- Përgatitja e shkresave, kërkesave të ndryshme gjatë kësaj periudhe si dhe raportime në mbledhjet e bordit të drejtorëve dhe Kryetarit të Komunës .

RAPORT TREMUJOR I PUNËS

JANAR-MARS BUXHET, ALOKIM, SHPENZIM

Përshkrimi	Lëndët e kryera	Buxheti fillestar	Alokimet	Shpenzimet	Shpenzim Buxhet fillestar %	Shpenzim Alokim %
Paga dhe Mëdtije		7,622,340	2,002,703.56	2,002,703.56		
Mallra dhe Shërbime	406	1,715,477	1,120,900.71	303,763.00		
Shpenzime Komunale	116	280,500	195,340.00	63,572.64		
Subvencione dhe Transfere	13	311,000	265,365.53	119,797.07		
Investime Kapitale	52	4,021,979	3,457,716.76	1,407,983.44		
Rezervat (për zbatimin e ligjit të pagave)	-	1,087,399	0	0	0.00	N/A
Totali	-	14,216,590	7,660,916	5,834,911		

Paraqitja grafike



Të hyrat vetanake :

Sektori i Tatimit në Pronë

- Objekte të reja të regjistruara: 20 objekte , ose 3,443m²;
- Verifikim i pronave ekzistuese: 136, ose 23,905 m²
- Të hyrat e realizuara: gjatë periudhës janar-mars 2021 Sektori i Tatimit në Pronë ka realizuar të hyra prej: 145,508.70 euro apo 29.13 % të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 499,593.00€);

Të hyrat në përgjithësi

Të hyrat e përgjithshme vetanake të planifikuara për vitin 2021 janë **1,061,093,04** euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumën prej: **281,486,78** apo **26,52** % të planifikimit vjetor.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, gjatë kësaj periudhe raportuese ka zhvilluar aktivitetet e saj në të gjitha fushat e veprimtarisë, me qëllim të rritjes së cilësisë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor si dhe ngritjes së përgjithshme të cilësisë së jetës së qytetarëve të komunës, përfshirë këtu edhe mbështetjen në fushat e shërbimeve sociale dhe më gjerë.

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në Planin e Punës për vitin 2021. Ky raport përfshin në mënyrë gjithëpërfshirëse shërbimet e ofruara në fushën e kujdesit parësor shëndetësor si dhe atë të veprimtarisë sociale, të arriturat dhe vështirësitë e hasura gjatë kësaj periudhe kohore.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

DSHMS qysh në fillim të vitit 2021 ka zhvilluar aktivitete të shumta, në kuadër të përgjegjësive të përkrahura, kemi realizuar gjithë aktivitetet e planifikuara, janë mbështetur projektet në të gjitha fushat e veprimit - shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar ofrimi i shërbimeve mjekësoreme dy ndërrime në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, poashtu në fshatrat Dejnë, Ratkoc dhe Krushë e Madhe, është shënuar përvjetori i dhurimit vullnetar të gjakut, dhurimi vullnetar i gjakut ka vazhduar edhe në fshatrat tjera të komunës sonë. Në të gjitha shkollat e komunës së Rahovecit janë mbajtur ligjërata për vetëdijësimin e popullatës kundër pickimit të rriqrave, dhe vetëdijësim të popullatës për mbrojtjen nga COVID-19.

Kjo periudhë raportuese është karakterizuar me një sërë aktivitete dhe masa të ndërrmarra nga Komuna e Rahovecit, si drejtori në funksion të mbrojtjes së shëndetit publik të popullatës dhe menaxhimit të situatës nga përhapja e Covid-19, kemi ngritur në nivel të lartë gatishmërinë për t'u ballafaquar me raste eventuale të këtij virusi, duke ndërrmarr masat e nevojshme për parandalimin e infeksionit nga Virusi Korona (COVID-19).

Në mënyrë që të ofrojmë shërbime profesionale dhe të sigurt për qytetarët, në të dy QMF-të në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, edhe ditën e shtunë po punohet me orar të rregullt.

Kemi bërë dezinfektimin e të gjitha objekteve dhe institucioneve publike, duke përfshirë të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit, si : objektet shëndetësore (QKMF, QMF-të, AMF-të), objektet e Administratës Komunale, objektet fetare: (Xhamitë dhe Teqet), Stacioni i Autobusëve, Stacioni Policor, objekte kulturore dhe sportive. Vlen të theksohet se objektet shëndetësore dezinfektohen çdo vikend, ndërsa reparti i mjekësisë familjare dhe kujdestaria dezinfektohen dy herë në javë për shkak se janë reparte më të frekuentuara nga qytetarët tanë.

Si Drejtori vazhdimisht jemi ballafaquar me mungesë të materialit mbrojtës për personelin mjekësor si maskat mbrojtëse, dorezat, dezinfektues, rroba mbrojtëse dhe syza mbrojtëse për personelin shëndetësor që janë vija e parë e frontit me COVID-19.

Jemi në fazën e vlerësimit të kontratave për furnizim me barna emergjente për nevojat e QKMF, barna dhe material shpenzues për stomatologji, dhe furnizim me reagenca për laborator, po ashtu kemi një furnizim të qëndrueshëm me O2, vlen të theksohet se janë duke u bërë teste rapide të shpejta për Covid-19.

Është miratuar propozim vendimi i kryetarit të komunës nga kuvendi komunal për subvencionim e të gjitha lindjeve në komunën e Rahovecit nga 200€, poashtu po vazhdon ndarja e ndihmave momentale për familjet në nevojë, në këtë tremujor të parë të këtij viti janë ndihmuar gjithsej: 146 familje në nevojë.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Ndërtimi i QMF-së në fshatin Optrushë, punimet janë duke vazhduar;

Mirëqenia Sociale:

Në kuadër të aktiviteteve nga fusha e mirëqenies sociale janë zhvilluar aktivitetet e parapara nga kjo fushëveprimtari, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi. Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto nevoja janë adresuar vazhdimisht në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendor dhe të huaj, poashtu, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare. Pra, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia.

Qendra për Punë Sociale dhe Organi i Kujdestarisë në kuadër të saj, si organ komunal profesional kompetent për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të rriturve, i përbërë nga një grup ekspertësh, ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ofrimin e ndihmës për personat në nevojë sociale, sipas procedurave të caktuara, në përputhje me mandatin ligjor.

DREJTORIA PËR ARSIM

Drejtoria për Arsim në 3 mujorin e parë të vitit 2021 ka punuar dhe është mundur t'i realizojë planifikimet e bëra të planit vjetor të punës, përkatësisht sipas planifikimeve të aktiviteteve të parapara gjatë këtyre 3 muajve. Aktivitetet dhe punët e kryera gjatë kësaj periudhe po i paraqesim të përmbledhura sipas muajve, siç vijon:

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

Në fillim të muajit janar, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës kemi dërguar kërkesat për furnizim me inventar për objektet e reja shkollore që janë në ndërtim e sipër. Jemi furnizuar me pako higjienike përmes Ministrisë së Arsimit dhe organizatës UNICEF dhe poashtu jemi furnizuar me 15 tabletë për

fëmijët me nevoja të veçanta. Punët kanë rifilluar në projektin e riparimit të shkollave (Lot1), përkatësisht në riparimin e dyshemeve në shkollën "Rudolf Ëalthër" të Dejnës dhe ndërrimin e dymës në klasave në shkollën "Katër Dëshmorët" në Ratkoc dhe në objektin e shkollës "Hamëz Thaçi" në Xërxë.

Kemi bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e mësimin në gjysmëvjetorin e dytë, kemi bërë pastrimin dhe dezinfektimin e shkollave dhe kemi planifikuar që Pakoja Pedagogjike për klasat 0 deri 5, të shpërndahet në të gjitha shkollat. Punët kanë vazhduar në projektin e riparimit të shkollave, përkatësisht në objektin e shkollës "Hamëz Thaçi" në Xërxë. Kemi mbajtur një takim në Kolegjin për Arsim në Prishtinë, në të cilin kemi hartuar planin e punës së kolegjit për vitin 2021. Kemi bërë vizita në disa shkolla për të parë nga afër ecurinë e fillimit të mësimin në gjysmëvjetorin e dytë dhe kemi shpërndarë Paket Pedagogjike për klasat 0 deri 5 në të gjitha shkollat.

Në muajin shkurt është mbajtur një takim me drejtorët e shkollave dhe me përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve të secilës shkollë, ku të pranishëm kanë qenë edhe pjesëtarët e stacionit policor në Rahovec. Në këtë takim kemi biseduar për sigurinë në shkolla dhe përgatitjet për fillimin e mbajtjes së garave shkollore të olimpiadës së matematikës dhe fizikës.

Nëpër shkolla ka filluar mbajtja e garave shkollore me nxënësit e klasave të 9, 10, 11, 12 të olimpiadës së matematikës dhe fizikës, të cilët pastaj do të jenë pjesë e garave komunale. Mbajtëm një punëtori me Caritasin e Zvicrës për zbatimin e projektit të pajisjes me inventar të klasave parafillore.

Nëpër shkolla ka përfunduar mbajtja e garave shkollore me nxënësit e klasave të 9, 10, 11, 12 të olimpiadës së matematikës dhe fizikës, të cilët pastaj morën pjesë në garat komunale. U mbajtën Garat komunale të Olimpiadës së Matematikës, e poashtu edhe Garat Komunale e Fizikanëve të Rinjë. Procesi i garave shkoi mire dhe të njëjtën ditë i angazhuam komisionet vlerësuese për të vlerësuar punimet e nxënësve dhe për nxjerrjen e rezultateve në nivel komune.

Punët kanë vazhduar në projektin e riparimit të shkollave (Lot1), në fasadimin e jashtëm të objektit të ri të shkollës "Haki Stërmilli" në Retijë dhe punimet në objektin e ri të shkollës "Herojntë e Kosovës" në Hoçë të Vogël-Brestoc.

Në muajin mars, punët kanë vazhduar në projektin e riparimit të shkollave (Lot1) në Guri të Kuq, Çifllak dhe në Drenoc, kanë vazhduar punimet në ndërtimin e çerdhes në Xërxë, ku u bë instalimi i rrjetit të rrymës elektrike e po ashtu edhe në çerdhen në Ratkoc. Punimet kanë vazhduar edhe në ndërtimin e shkollës në Retijë dhe Kaznik e poashtu edhe në Fortesë. Kemi nisur procedurën për realizimin e projektit "Furnizimi i bibliotekave të shkollave me libra" dhe procedurën e projektit "Instalimi i kamerave në shkollat e komunës së Rahovecit".

Për nder të festës së 7 Marsit nderuam me mirënjohje të pensionuarit e vitit të fundit, veteranët e arsimit që kanë mbi 70 vjetë dhe familjarët e mësimdhënësve të ndjerë që humbën jetën gjatë periudhës së pandemisë. Në Ministrinë e Arsimit kemi dërguar specifikacionet për pajisjen me inventarë të 3 çerdheve të reja. Edhe gjatë këtij muaji, punët kanë vazhduar në projektet e riparimit të shkollave (Lot1 dhe Lot2) në Çifllak ku u punua në ndërtimin e aneksit të nyjeve sanitare të shkollës, në Drenoc ku ka përfunduar montimi i dymës të klasave dhe do të vazhdohet me punët e dyshemeve të klasave.

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planin e punës për vitin 2020. Në kuadër të drejtorisë së DEZHT-së, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar një mori aktivitete.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

Gjatë kësaj periudhe raportuese të vitit 2021 është bërë regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2020 dhe regjistrimi në librin e ri të vitit 2021, poashtu, gjatë fillimit të vitit 2021 është bërë edhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2021 në formë elektronike, përpilimi dhe analizimi i ngarkesave të taksës afariste komunale për vitin 2021.

Në tremujorin e parë të vitit 2021 është bërë shtypja e aktvendimeve për të gjithë bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale ku në bazë të kësaj ne kemi arritur të kemi një rritje të konsiderueshme të të hyrave në taksa afariste komunale.

Pas reshjeve dhe vërshimeve të mëdha gjatë muajit janar kemi formuar komisione për vlerësimin e dëmeve në amvisëri, ku nga ky komision është hartuar raporti profesional, i njëjti është dërguar në Ministrinë e Pushtetit Lokal sipas katalogut të kërkuar, në mënyrë që të përkrahen të gjithë të dëmtuarit në amvisëri. Pas insistimit të vazhdueshëm drejtuar MPL-së, për të gjithë të dëmtuarit në amvisëri komunës së Rahovecit i janë ndarë 151,000.00 €.

Ofrimi i mbështetjes për bizneset fillestare dhe atyre ekzistuese të vogla e të mesme, vazhdon të mbetet prioritet i yni me rëndësi, andaj gjatë kësaj periudhe janë vizituar shumë biznese të komunës së Rahovecit për të parë nga afër mbarëvajtjen e procesit të punës, nevojat dhe kërkesat e tyre drejtë realizimit në të bërit biznes dhe mundësinë e të ofruarit ndihmë për zhvillimin e këtyre bizneseve me të gjitha kapacitetet që ne i posedojmë. DEZHT, ku gjatë kësaj periudhe raportuese janë përkrahur sin ë vijim: Lirimi nga taksa komunale të gjitha bizneset që operojnë në komunën e Rahovecit të cilat janë të ngarkuara me rregulloren për taksa komunale 01. Nr 80/20 e datës 29.06.2020 per periudhën: 01.01.2021 deri më 31.12.2021, përveç disa bizneseve si: bankat, KEDS, pompat e derivateve kompanitë e sigurimeve dhe barnatoret shëndetësore. Poashtu është bërë lirimi nga qiraja mujore për të gjithë personat fizik dhe juridik të cilët shfrytëzojnë pronën komunale (objektet komunale dhe lokaleve afariste), me vendim të Kuvendit me Nr.172/2021.

Vlen të theksohet se kemi bërë edhe përkrahjen e 52 bizneseve që operojnë në territorin e komunës sonë, me mjete financiare në vlerë prej :20.000 euro.

Nga Ministria e Zhvillimit Rajonal kemi fituar projektin në vlerë prej 50,000.00€ për rregullimin e tregut në fshatin Ratkoc.

Zyra e ARBK-së:

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës. Evidenca e regjistrimit të bizneseve të Komunës së Rahovecit sipas bazës së programit online të ARBK mbahet në mënyrë të rregullt.

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar-mars 2021:

Nr.	Përshkrimi	
1.	Kërkesë për regjistrim të bizneseve	46
2.	Biznese të regjistruara B.I.	26
3.	Biznese të regjistruara SH.P.K.	20

Kërkesë për shtimin apo heqjen e aktivitetit	
	18
Kërkesë për ndryshim emrit tregtarë	
	6
Kërkesë për shuarje të njësisë	
	5
Kërkesë për ndryshim të adresës	
	5
Kërkesë për shtim apo ndryshim të njësisë	
	4
Kërkesë për ndryshimin e pronarëve/aksionarëve	
	3
Kërkesë për ndryshim të emrit	
	1

Dhjetë (10) aktivitetet që shërbehen më së shumti nga bizneset:	
Instalime të tjera ndërtimore:	7
Instalime elektrike:	6
Punime hidraulike dhe Instalime të Ngrohjes dhe kondicionerit të ajrit:	6
Aktivitetet Shërbyese të Pijeve:	5
Aktivitetet e tjera të specializuara ndërtimi p.k.t:	5
Tregtia me shumicë jo e specializuar:	4
Përfundimi dhe finalizimi i punëve të tjera të ndërtesave:	4
Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore:	4
Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, etj:	4

Zyra për Taksa Afariste Komunale

Tabela e të hyrave për periudhën raportuese janar- mars 2021

Muajt	Të hyrat
Janar	4,002.00€
Shkurt	8,806.46€
Mars	5,681.00

Sektori për Turizëm

Zyra për Informacione Turistike, gjegjësisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm i ka zbatuar detyrat dhe obligimet për periudhën raportuese si në vijim:

- Pjesëmarrja në takimet e një-pas njëshme përmes Zoom me SOLICO, e bazuar në Austri.
- Dalja në teren për shpërndarjen e informatave për Skemën e Granteve në kuadër të PREDA, Prizren mbështetur nga Qeveria Gjermane;
- Informimi i bizneseve, kryesisht verarive të Rahovecit për dërgimin e materialit tek zyra e TIC-ut për promovim të turizmit të verës së Rahovecit përmes Kompanisë Gjermane Europa Design;
- Përpilimi dhe përgatitja e materialit për promovim të turizmit të Rahovecit si dhe dërgimi në mënyrë elektronike tek kompania Gjermane Europa Design.

Sektori për Zhvillim

Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt dhe është siç vijon:

1	Të hyrat nga qiraja për periudhën janar - mars 2021	3,060.00 €
2	Të hyrat nga saldoja për periudhën janar- mars 2021	10,357.20 €
1	Pëlqime pune për biznese për periudhën janar – mars 2021	10

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Shtëpia e të moshuarve për qëndrim ditor- Mbi qytetin e Rahovecit, tek “Epojeja e UÇK-së”, po vazhdon ndërtimi i shtëpisë për të moshuar për qëndrim ditor. Kjo është kërkesë e kahershme e qytetarëve të moshës së shtyer dhe Komuna e Rahovecit do ti jep jetë si investitor me vlerën e kontratës: 89,979.00 euro. Në këtë qendër parashihet të ketë një sallë kolektive për qëndrim dhe aktivitete, dhoma për të pushuar si dhe teracë, projekti tashmë është në fazën përfundimtare;

- Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në Komunën e Rahovecit – Ky projekt është duke vazhduar, kemi përfunduar me krijimin e tri shtigjeve të ecjes në fshatrat Dejnë, Drenoc si dhe në pikën turistike Zhdrellë, punimet kanë përfunduar edhe në fshatin Krushë e Madhe për ndërtimin e projektit të Shtegut të Ecjes, " LULET E MARSIT" është bërë poashtu edhe pastrimi i shtegut. Ka filluar edhe ndërtimi i Shtegut të ecjes në Gradish.
- Investime në infrastrukturë, në Zonën ekonomike- Më datë 22.06.2018, me vendim të Qeverisë së Kosovës është krijuar Zona Ekonomike në Oplotushë me një hapësirë prej 35,84 ha, poashtu është bërë licencimi i zonës industriale nga ana e MTI-së, ka mbetur të bëhet fillimi i investimeve direkte në zonë, deri më tani është përfunduar rrethimi i një pjese prej 1500m me mur mbrojtës si dhe pastrimi përreth kësaj zone.

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Në fillim të vitit 2021, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ka publikuar planin vjetor të punës, në të cilën është bazuar edhe në punën e bërë në tremujorin e parë për të cilën do të raportohet në këtë raport pune për muajt; janar, shkurt dhe mars.

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit funksionojnë dy sektorë:

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit dhe
- Sektori i Mjedisit.

Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit

Gjatë periudhës raportuese në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit janë kryer punët të cilat janë paraparë, në bazë të Planit të Punës për vitin 2021. Kërkesat e palëve në këtë sektor janë shqyrtuar në afatin ligjor. Janë shqyrtuar kërkesa të qytetarëve, janë aprovuar, janë refuzuar dhe janë ceduar sipas procedurës së aplikushme administrative.

Nga këto kërkesa janë lëshuar: kushte ndërtimore, leje ndërtimore, leje rrënimi, leje të legalizimit, pëlqime, leje përdorimi, ndërrim-destinimi, vërtetime urbanistike, vendime, referenca, njoftime dhe shkresa të tjera.

Sektori i Mjedisit

Në kuadër të sektorit të mjedisit shqyrtohen kërkesat nga qytetarët për Leje Mjedisore Komunale si dhe kryhen aktivitete të tjera rreth mbrojtjes së mjedisit.

Gjatë periudhës janar – mars në këtë sektor janë lëshuar - Leje Mjedisore Komunale dhe janë realizuar të hyra. Në kuadër të këtij sektori nuk kanë mundur të realizohen disa aktivitete në fushën e mjedisit si: shënimi i Ditës Botërore të Pyjeve, Ditës Botërore të Ujit, Ditës Botërore të Tokës dhe Ditës Botërore të Mjedisit dhe Ditës Botërore të Pastrimi, kjo për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

- Projekti i ndërtimit të tetë parqeve në Komunën e Rahovecit ka vazhduar edhe në këtë periudhë raportuese, Komuna e Rahovecit ka ndërtuar parqe në Gexhë, Malësi të Vogël, Pataqan të Poshtëm, Dobidol, Sapniq, Celinë, Zaqisht dhe Ratkoc. Do të ndërtohen edhe në shumë vendbanime të tjera gjatë vitit 2021;
- Ka përfunduar projekti i Kompleksit të Dëshmorëve në Gradish/Xërxe, kushtuar dëshmorëve të komunës së Rahovecit;
- Ndërtimi i kullës prej guri për heronjtë Xhelal Hajda – Toni dhe Selajdin Mullabazi– Mici te vendi i rënies mbi fshatin Operushë, punimet janë afër përfundimit;
- Ka përfunduar ndërtimi i lapidarit “Altari i Lirisë”, kushtuar martirëve të fshatit Guri i Kuq;
- Është lidhur kontrata për mbjelljen e mbi 10 mijë drunjve në komunën e Rahovecit. Deri më tani nga kjo kontratë janë mbjellë rreth 7000 drunj, sipas kontratës i kemi të parapara edhe 7000 të tjerë, po ashtu do të lidhim edhe një kontratë gjatë vitit 2021 për t’i mbjellë 20.000 drunj, ashtu siç ka qenë zotim elektorale. Drunjtë janë mbjellur në qytetin e Rahovecit, në hyrje-dalje të Rahovecit, në Drenoc, Polluzhë, Kramovik, Guri i Kuq, Mrasor, çifllak, Dejnë, Ratkoc, Malësi e Vogël, Gexhë, Xërxe, Fortesë, Krushë e Madhe, Hoçë e Vogël, Brestoc, Opterushë dhe Zaqisht. Drunjtë do të mbillen në të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit. Ata drunj që kanë dështuar do të zëvendësohen;
- Komuna e Rahovecit momentalisht është duke investuar në trajtimin e shtretërve të lumenjeve në Krushë të Madhe, i financuar nga Komuna. Në fshatrat Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogel dhe Nagac, financuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. Trajtimi i përrrenjve në fshatrat Opterushë, Pataqan i Poshtëm, Malësi e Vogël dhe Polluzhë, bashkëfinancim me grantin e performancës dhe Komunës së Rahovecit. Probleme me shtretër të përroskave kemi në fshatrat Dejnë, Ratkoc, Celinë, Sapniq, Gexhë, një përroskë e vogël në Brestoc, pjesën e poshtë të lumit Duhillo në Rahovec e përroska tjera të vogla, të cilat do t’i trajtojmë me një kontratë tjetër;
- Po trajtohen të gjitha lapidaret, vendrëniet e dëshmorëve, pllakat përkujtimore, platore të shtatoreve të heronjëve dhe busteve të dëshmorëve dhe dy shtëpitë muze, e Bedrush e Feim Gashit në Drenoc dhe Skënder Rexhepit në Mrasor, financuar nga Komuna e Rahovecit.
- Po rinovohen komplet varrezat e martirëve në Celinë, financuar nga Komuna e Rahovecit;
- Këtë vit do të përfundojnë punimet në projektin e rregullimit të rrugëve me gurë në pjesën e vjetër të qytetit. Përveç rrugëve ka ndriçim dhe trajtim të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike;
- Projekti i Ndërtësës së Përbashkët për Banim Social në Rahovec, pritet të përfundojë së shpejti. Mjetet janë të planifikuara. Vonesa është shkaktuar nga trashëgimi i borxhit të madh në atë projekt.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike, në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Planit të Punës për vitin 2021, përkundër sfidave dhe vështirësive ka përfunduar me sukses një sërë projektesh dhe ka realizuar një mori aktiviteteve përgjatë kësaj periudhe tremujore. Në vazhdim DSHP ka raportuar nmbi thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

- Gjatë muajit janar janë kryer disa punë në intervenimeve emergjente;
- Kemi vazhduar punën me 3 kompanitë e kontraktuara nga Komuna e Rahovecit, në menaxhimin sa më të mirë të mirëmbajtjes së rrugëve dimërore, edhe pse nuk ka pasur shumë të reshura të borës, kompanitë janë angazhuar në pastrimin e rrugëve nga mbeturinat;
- Gjatë muajit janar komuna e Rahovecit ka filluar punën me ndriçim publik, në fshatin Gur i Kuq poashtu edhe në vendbanime tjera sipas kontratave të nënshkruara;
- Sipas planit të prokurimit të dorëzuar në dhjetor, DSHP do t'i respektojë datat e dhëna në planifikim, do të fillojmë me përgatitjen e dy projekteve, projektin për furnizim me gypa dhe projektin për Intervenime emergjente;
- Në këtë periudhë, janë përfunduar disa punë, si raporti vjetor i DSHP-së, plani i prokurimit, vlerësimi i punëtorëve;
- Është bërë kërkesë në kompaninë rajonale të mbeturinave Ekoregjioni për shtrirjen e kompanisë edhe në 3 vendbanime si dhe kërkesa për punëtorë shtesë prej 10 personave, është rritur zgjerimi i kompanisë Ekoregjioni në fshatrat Fortesë, Xërxë dhe Zatriq;
- Gjatë kësaj periudhe komuna e Rahovecit, respektivisht DSHP ka qenë e angazhuar gjatë tërë kohës me intervenime emergjente në disa prej vendbanimeve të komunës sonë, ku ka pasur aktivitete në deblokimin e kanalizimeve, rregullimin e disa rrugëve, dy segmente në Gur të Kuq, një segment në Polluzhë, një segment në Potoqan si dhe pastrimin e përroskave në Celinë, Brestoc, Malësi e Vogë, Cifllak dhe në shumë pozicione të tjera;
- Në fillim të muajit shkurt janë kryer disa punë të intervenimeve emergjente, në fshatin Pastasel në rregullimin e rrugëve me zhavorr, në fshatin Pataqan i Poshtem si dhe në fshatin Gur i Kuq;
- Gjatë muajit shkurt komuna e Rahovecit ka filluar punën me ndriçim publik edhe në disa lagje të qytetit dhe në vendbanime të tjera, në fshatin Gur i Kuq ka përfunduar, instalimet nëntokësore janë vendosur në fshatin Gexhë dhe në fshatin Fortesë;
- Gjatë muajit shkurt është bërë prezantimi i pilot projektit të impiantit nga një kompani Gjermane;
- Në muajin mars, kanë vazhduar projektet e ndriçimit publik në dy vendbanime, instalimet nëntokësore janë vendosur në fshatin Gexhë dhe fshatin Fortesë, ndërsa pas finalizimit të këtyre projekteve vazhdojmë në vendbanimet Brestoc, Hoqë e Vogël, Senoc, Kramavik etj...
- Kanë rifilluar punimet në ndërtimin e rrugëve në 3 Lot, kompania Seti Comerc ka vazhduar punën në Ratkoc dhe në fshatin Vrajakë;
- Projekti i zgjerimit të rrjetit të ujërave fekale dhe atmosferike, ka vazhduar me dy kompanitë e kontraktuara, kanë rifilluar punimet në qytet si dhe një ekip do të fillojë punën në Dejn, sipas kontratës po ashtu edhe kompania Co Ing ka rifilluar punët sipas kontratës, do të bëhen përmirësimet e disa ndërhyrjeve në rrugë gjatë punimeve që janë bërë në kanalizime;
- Ka rifilluar punimet kompania Mendi-P, në ndërtimin e kanalit atmosferik në qytet, në rregullimin e ndriçimit publik në rrugën Xërxë-Sapniq-Ratkoc;

- Nga data 1 mars kompania për mbledhjen e mbeturinave KRM Ekoregjioni njësia në Rahovec bën shtrirjen edhe në 3 vendbanime, Fortesë, Xërxë dhe Zatriq, kërkesë kjo e donatorëve që ka komuna e Rahovecit;
- Janë ftuar kompanitë për rifillimin e punimeve në rrugën 4 korsi;
- Gjatë kësaj periudhe ka pasur aktivitete në mjedis, ka filluar edhe krasitja dhe mirëmbajtja e drunjtëve dekorativ sipas kontratave ekzistuese me operator ekonomik;
- Kompania Fidani-L ka rifilluar punimet në qytet në rrugën Ali Hasku, janë tejkaluar problemet pronësore, në vendosjen e rrjetit nëntokësor të ujërave fekale, atmosferike dhe rrjetit të ri të ujësjellësit;
- Me zgjerimin e rrjetit të kanalizimit është duke vazhduar edhe kompania Co Ing ka rifilluar punët sipas kontratës, do të bëhen disa përmirësimet që janë bërë në kanalizime, si dhe zgjerimin e rrjetit të ri në disa lagje në qytet, në disa lagje janë duke u kryer zgjerimi i rrjetit të kanalizimit,
- Gjatë muajit mars, janë mbajtur takime të përbashkëta në mes të komunës së Rahovecit, KRU Gjakovës si dhe donatorëve të tjerë për zgjidhjen e problemit me ujin e pijshëm, në zonën e tretë në Rahovec, Hoçë e Madhe, Zoqisht, Zonën Ekonomike dhe për fshatin Opterushë;
- Janë bërë disa përmirësime në mirëmbajtjen e rrugëve në qytet, janë asfaltuar disa gropa të krijuara në disa rrugë;
- Ka rifilluar punimet në rrugën 4 korsi, Lot 3 kompania Mendi –P nga rrethrotullimi i hyrjes së qytetit, ka filluar zgjerimi dhe do të vendosen gypat nëntokësor për trajtimin e ujërave fekale dhe atmosferike;
- Gjatë muajit mars, komuna e Rahovecit ka bërë marrëveshjen me Ministrinë e Infrastrukturës për projektin e rrugëve në qytet, me të gjitha elementet përcjellëse në rrugë;
- Poashtu në këtë periudhë është mbajtur një takim në mes të stafit të DSHP-së dhe kompanisë projektuese për të harmonizuar detyrën projektuese dhe projektin detal të rrugëve në qytet.

Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2021 janë:

- Sfidat e drejtorisë do të jenë mundësitë buxhetore që kemi si drejtori, kemi shumë kërkesa të ndërtimit të rrugëve lokale dhe për të përfunduar rrugë dytësore dhe të pa kategorizuara, ka me qindra kërkesa që po adresohen ne drejtori;
- Mirëmbajtja e përrrenjve dhe kanaleve që gjenden në vendbanime dhe në lagjet urbane;
- **Kërkesa të vazhdueshme për ndriçim publik; për ndërtim të trotuareve; mbeturinat e amvisërisë që fatkeqësisht hidhen kudo, vend e pa vend ku krijohen deponitë ilegale;**
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë të shtrirë rrjetin e KRU Gjakovës.

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2021, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vehte aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve, i ndarë në periudha tremujore.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitete. Ndër më kryesoret do të paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranim i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2020 për fermerët blegtor (MBPZHR hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë kjo thirrje ka qenë e hapur nga: 15 janar deri më 15 shkurt);
- Kemi mbajtur kontakte të vazhdueshme me zyrtarët e AZHB-se lidhur me aplikacionet dhe plotësimin e tyre për aplikimet e vitit 2020. Shumë fermerë kanë pasur probleme me llogari bankare ku është kërkuar nga ne që të i ndryshojmë në mënyrë që të realizojnë pagesat e tyre;
- DBPZHR ka ndërmarrë masat dhe është përgatitur me kohë për hapjen e thirrjeve nga MBPZHR për pagesa direkte (jemi kujdesur që të furnizohemi me material administrativ për të përballuar fluksin e madh të fermerëve);
- Sikurse vitin e kaluar, kemi kryer të gjitha përgatitjet rreth funksionalizimit të zyrave në dy qendrat më të mëdha të komunës sonë për aplikim të fermerëve, atë në Ratkoc dhe Krushë të Madhe. Me kohë jemi pajisur me qasjet e nevojshme në të gjithë softverët që janë të lidhur me plotësim të dokumenteve që kërkohen nga MBPZHR. Poashtu leje e veçantë nga Agjencioni Kadastral i Kosovës për mundësinë e nxerrjes së dokumenteve të pronësisë edhe në këto dy qendra. E gjithë kjo me të vetmin qëllim për të ju lehtësuar fermerëve të komunës sonë këtë proces;
- Jane inicuar procedurat dhe kemi arritur që të lidhim 7 kontrata për konsulent që do të angazhohen në DBPZHR, të cilët do të pranojnë aplikacionet e fermerëve për pagesa direkte;
- Duke u bazuar në kërkesat e fermerëve për marrje të tokave bujqësore me qera për qëllime bujqësore, tani jemi në përfundim të përzgjedhjes së fermerëve që do të marrin kontratën për shfrytëzim të tokave bujqësore. Ankandi Publik ka qenë i hapur dhe janë respektuar të gjitha procedurat sipas ligjit për dhënie të tokave bujqësore komunale me qera;

- Si vazhdimësi e projektit për përkrahje të fermerëve me mekanizëm bujqësor, në muajt janar dhe shkurt janë shpërndarë pajisje për fermerët përfitues me të cilët kemi lidhur kontratë;
- Pas hapjes së thirrjes nga MBPZHR për aplikim në skemën e grantve nga 15 janar deri me 1 mars kemi bashkëpunuar ngushtë me kompaninë konsulente për hartim të projekteve dhe rregullim të dokumenteve për fermerët e komunës sonë;
- Gjatë muajt janar si pasojë e reshjeve dhe vërshimeve janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në sektorin e bujqësisë. Komisioni ka dalë në terren për evidentimin e dëmeve të shkaktuara duke u bazuar në kërkesat e fermerëve, ka përpiluar procesverbal për secilin fermer dhe ka hartuar raport përfundimtar të cilin e kemi dërguar në Ministrinë e BPZHR-së;

Nr.	Kultura	Vlera në €
1	Perimekulturë, Lavërtaria, Blegtoria dhe Vreshtaria	333.976.78 €

- Pranimit dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët, si dhe
- Shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: Vërtetim për fermer, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë, si dhe barazimi mujor i të hyrave me Drejtorinë e Financave etj.

Projektet e investimeve kapitale

Qysh në fillim të vitit kanë rifilluar punimet në projektet ku kemi kontratë me Operatorët Ekonomik.

- Ka vazhduar ndërtimi i serave të pa përfunduara pas shpalljes së rezultateve nga komisioni, punimet janë duke vazhduar edhe këto ditë. Të dy Operatorët Ekonomik që kanë kontratë me Komunën e Rahovecit janë duke i ndërtuar serrat në terren. Në Lot 1. Janë duke u ndërtuar serrat nga 3 ari dhe 10 ari, ndërsa në Lot 2. Janë duke u ndërtuar serrat nga 5 ari dhe 7 ari.
- Poashtu qysh në fillim të vitit ka filluar ndërtimi i stallave për përfituesit në sektorin e blegtorisë. Aktualisht është duke u ndërtuar shtalla e fundit, ku me përfundimin e këtij projekti hapet rruga për lidhjen e kontratës së re.
- Përmes kategorisë së subvencioneve në kuadër të drejtorisë është bërë vaksinimi i bagëtive në komunën e Rahovecit si dhe vaksinimi i qenve shtëpiak me pronar.
- Është në përfundim projekti i trajtimit të qenve endacakë në komunën tonë, ku përmes kësaj kontrate janë trajtuar rreth 400 qenë në lokacione të ndryshme.

PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Duke u bazuar në planin e punës kemi devijim nga ajo çka ne kemi planifikuar pasi që periudha e parë që përfshinë muajt janar, shkurt dhe mars kemi paraparë që të zhvillohet procesi i aplikimit për pagesa

direkte-subvencione në kuadër të MBPZHR-se, dihet që akoma nuk është hapur thirrja dhe për këtë arsye kemi mospërbushje të planit të punës me raportin për këtë periudhë.

Kontakti me qytetarët dhe me grupet e interesit për të trajtuar dhe zgjidhur së bashku kërkesa, nevoja dhe interesa të tyre, është i vazhdueshëm. Zyrtarët e DBPZHR-së vazhdimisht janë në terren duke takuar fermer në sektor të ndryshëm dhe duke iu ofruar këshilla të nevojshme rreth aktiviteteve agroteknike nëpër fermerat e tyre. Poashtu nga fermerët kemi marr informata për pajisjet që iu nevoiten atyre, ku ne do të i përfshijm në thirrjet për aplikim që do të hapen tremujorin e dytë. Kemi krijuar raporte të mira me OJQ-të, me grupe të ndryshme, profesionist të fushave, me theks të veçantë inxhiner të bujqësisë ku kemi pranuar këshilla, vërejtje dhe ide në mënyrë që të përmirësohemi dhe të zhvillojmë bujqësinë përditë e më mirë.

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Fillimi i vitit të ri është karakterizuar me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak. Qysh në fillim të vitit 2021 i jemi qasur punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për Vitin 2021.

Gjatë periudhës tre mujore për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e Drejtorisë i kanë përfunduar këto punë:

Spektori:	Lëndët:	Shuma €
Kadastër dhe Pronë	197	3,110 €
Gjeodezi	927	2,410 €
Referenti	1,040+58 L.Z.	3,640 €
Totali	2,164+58 L.Z.	9,160 €

Gjatë muajit janar i kemi përfunduar këto punë:

- Kemi përgatitur material të nevojshëm për mbledhjen e Kuvendit Komunal me kërkesë të këshillit të fshatit Pastasel i cili është mbajtur në fund të Janarit 2021 në të cilën kemi shpallur interes të përgjithshëm në Z.K. Rahovec dhe kemi caktuar lokacion për ndërtimin e një objekti i cili do të jetë në shërbim të komunitetit të fshatit për nevoja kulturore
- Me kërkesë zyrtare të inspektoratit kemi dalë në teren dhe kemi inqizuar gjendjen në disa Zona Kadastrale në nivel të Komunës të cilat nuk kanë rezultuar me uzurpim të pronës publike.
- Me kërkesë të drejtorisë së shërbimeve publike kemi kufizuar disa rrugë në Zona Kadastrale Rahovec, Krushë e Madhe dhe Ratkoc të cilat planifikohen të kubëzohen.
- Avokati i komunës me kërkesë zyrtare ka kërkuar dokumentacione të ndryshme të cilat i shërbejnë në procedura gjyqësore për mbrojtje të pronës komunale.
- Eshtë mbajtur trajnimi i punëtorve nga AKK në Prishtinë në lidhje me pjesën e dytë për pranimin e lëndëve nga drejtoria e Urbanizmit në lidhje me legalizimin e objekteve pa leje dhe regjistrimi i

tyre në librat kadastral, ky proces ka përfunduar dhe tashmë lëndë po pranohen dhe po regjistrohen.

Gjatë muajit shkurt i kemi përfunduar këto punë:

- Me kërkesë zyrtare të asambleistëve të Kuvendit të Komunës kemi dalë në terren në disa Zona Kadastrale si në: Rahovec, Radoste, Krushë e Madhe etj. dhe kemi kufizuar parcela publike si: rrugë, shkolla etj.
- Me kërkesë zyrtare të drejtorisë së bujqësis kemi përfunduar nxjerrjen e koordinatave për rrugë fushore për disa Zona Kadastrale në nivel Komune.
- Me kërkesë të palës kemi dalë në terren në ZK Rahovec për identifikimin e pronës private, inqizimin dhe matjen për hapje të rrugës publike sipërfaqe këtë të cilën e kemi shpallur në mbledhjen e Kuvendit në fund të shkurtit zonë me interes të përgjithshëm.
- Kemi përgatitur raport-informatë në lidhje me të gjithë pronarët të cilët kanë prona në zonën e mbrojtur të Kanionit Drini i Bardhë.
- Me kërkesë zyrtare të Inspektoratit kemi dalë në terren në lidhje me vërtetimin e pretendimeve për uzurpim të pronës publike në disa Zona Kadastrale në nivel të Komunës.
- Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesës së palëve në lidhje me faljen e pronës private për hapje të rrugës dhe përkthimi në pronë publike në disa Zona Kadastrale në Rahovec.
- Nxjerja e aktvendimeve për uzurpim të pronës publike.

Gjatë muajit mars i kemi përfunduar këto punë:

- Me kërkesë të drejtorisë së shëndetësisë kemi dalë në terren në ZK Rahovec dhe kemi kufizuar parcelën publike ku planifikohet të ndërtohet Shtëpia e Shëndetit.
- Pas kërkesës së drejtorisë së shërbimeve publike dhe urbanizmit kemi dalë në terren dhe kemi kufizuar përroskën në fshatin Xërxë deri në Drinin e Bardhë.
- Me kërkesë të drejtorisë së arsimit kemi dalë në teren dhe kemi kufizuar parcelën në ZK Hocë e Vogël ku po ndërtohet shkolla fillore.
- Me kërkesë të drejtoriës së shërbimeve publike kemi përgatitur koordinata të rrugës katër korsi të segmentit të dytë në rrugën Rahovec- Xërxë.
- Kemi përgatitur materialin e nevojshëm për Kuvendin e Komunës për këmbim të pronës publike me pronë private në ZK Rahovec për hapje të rrugës publike.
- Përgjigje në kërkesat e parashtruara nga Avokati i Komunës.
- Punë tjera sipas kërkesave të palëve.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për gjatë tremujorit të parë, ka përfunduar aktivitete të planifikuara në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve, duke udhëhequr me resurset (burimet) lokale kulturore, sportive e rinore të Komunës së Rahovecit.

Në raport të punës janë të përfshira shumica e aktiviteteve të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete e projekte, në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë.

Personeli i DKRS-së përgjatë kësaj periudhe, është angazhuar që të gjitha projekte e aktivitete të parapara të përfundohen me sukses, duke bërë përpjekje edhe për sigurim të mbështetjes financiare shtesë, përfshirë mbështetje nga niveli qendror; MKRS dhe donatorë

të ndryshëm vendor e ndërkombëtar.

Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara përgjatë kësaj periudhe.

Çfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmbledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në mars të vitit 2021. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së. Aktivitetet e DKRS-së për periudhën raportuese të tre mujorit të parë të 2021 janë:

Aktivitetet e DKRS-së për periudhën raportuese të tre mujorit të parë janë:

Në tre muajt e parë të vitit 2021, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, janë realizuar shumë takime me partner dhe palë të jashtme, ku jemi përkushtuar maksimalisht në arritjen e objektivave në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke përmbyshur planin e punës, qëllimet dhe arritjen e objektivave për këtë periudhë kohore.

- Realizimi i planit të veprimit për vitin 2021,
- Kontrollimi i raporteve të projekteve të subvencionuara nga DKRS-së nga viti paraprak,
- Përgatitja e planit të prokurimit për projekte kapitale

Për nder të manifestimit tradicional, kulturor e përkujtimor “Flaka e Janarit”, është formuar Këshilli Organizues, nga i cili janë planifikuar këto aktivitete.

- Mbajtja e homazheve dhe nderime për dëshmorët e kombit Nesimi Elshani, Agron Fetahu, Halim Hoti dhe Hilmi Krasniqi, të rënë në Brestoc më 27 Janar 1990
- Mbajtja e manifestimit përkujtimor e kulturor në shkollën e muzikës “Faik Sylka”

- Mbjtja e homazheve dhe nderimeve për dëshmorin e kombit Sahit Krasniqi në Varezat e Dëshmorëve – Ratkoc.

Për nder të 17 shkurtit –Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, janë organizuar një varg aktiviteteve kulturore – artistike dhe sportive:

- Formimi i Këshillit Organizues për nder të ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës
- Shpallja e njoftimit për regjistrimin e ekipeve, për garat e organizuara për nder të 17 shkurtit.
- Organizimi i lojës miqësore ndërmjet dy kulubeve të futbollit në Rahovec, atij të KFS “Rahoveci” dhe KFS “Rahoveci 2019”.
- Mbjtja e homazheve në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Rahovec
- Mbjtja e programit festiv, organizuar në Shkollën e Muzikës “Faik Sylka” në Rahovec.
- Mbjtja e seances solemne në Kuvendin Komunal të Rahovecit.
- Në kuadër të kësaj dite është organizuar gjithashtu edhe një ekspozitë personale e artistit Fehmi Hoxhës – Feho.

Shpallja e Thirrjes Publike për subvencionim të Sportit.

- Qëllimi i kësaj thirrje publike është mbështetja financiare për klubet e sportit, OJQ – të dhe sportistët individual, që aktivitetin dhe fushëveprimtarin kryesore e kanë sportin dhe projektet që ndërlidhen me vetëdijesimin dhe përfshirjen e të rinjëve të komunës së Rahovecit në aktivitetet sportive.

Formimi i Këshillit Organizues të Festivalit Tradicional Folklorik “Anadrinia Jehon 2021” - me vendim të kryetarit z. Smajl Latifi.

- Këshilli ka për detyrë të ndërmarr të gjitha veprimet organizative për mbarrëvajtjen e festivalit, përfshirë seleksionimin e grupeve artistike pjesëmarrëse në festival, rregullimin e skenës, përzgjedhjen e juries profesionale për vlerësim, shpërndarjen e ftesave për pjesëmarrësit si dhe ndarjen e çmimeve të festivalit në natën finale.

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport më 20 Janar 2021, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Komitetin Olimpik të Kosovës me president z. Besim Hasani për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2021.

Pasurimi i Bibliotekës “Sulejman Krasniqi” - Rahovec, me një fond librar prej 210 tituj të rinj të librave.

- Kjo u mundësua me përkrahjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), në një ceremoni tashmë tradicionale që ministria organizon çdo vit.

Shpallja e thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.

- Qellimi i kësaj thirrje publike është mbështetja e të gjithë organizatave jo – qeveritare dhe individëve të regjistruar në Republikën e Kosovës e që veprojnë në komunën e Rahovecit, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kultures dhe rinis e që kontribuojnë në promovimin dhe avancimin e kulturës dhe rinisë në komunën e Rahovecit.

Rreth 600 ekzemplar me libra janë dërguar në Ratkoc, ku shumë shpejt pritet të aktivizohet edhe dega e tretë e bibliotekave, në kuadër të hapësirës së Shtëpisë së Kulturës “Jah Hoti”.

- Duke pasur parasysh nevojën e ngritjes së lexueshmërisë në vendin tonë, komuna e Rahovecit ka paraparë hapjen e disa degëve të Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi”, duke i mundësuar lexuesëve qasje në ambiente sa më të afërta për përfitim të njohurive dhe informacioneve të reja.

Është riorganizuar objekti i Qendrës së Kulturës “JAH HOTI” në Ratkoc.

- Objekti i Qendrës së Kulturës “JAH HOTI” në Ratkoc, ka sallë të madhe për tubime e aktivitete të ndryshme, bibliotekë, zyrat e gjendjes civile (ofiqarisë) e mjedise të përshtatshme brenda, e që së bashku me parkingun dhe hapësirën përreth objektit, i japin funksionalitet, bukuri, shije kësaj hapësire. Besojmë se kjo vatër e kulturës do të ofrojë mundësi më të mëdha për të rinjtë e kësaj ane, si dhe për komunitetin në përgjithësi, ndaj, kemi detyrim të përbashkët që ta mirëmbajmë!
- Në sallën e mbledhjeve të kuvendit komunal të Rahovecit, në ceremoninë e organizuar nga kryetari i komunës, Smajl Latifi i është ndarë çmimi “Qytetar Nderi i Komunës së Rahovecit”, Tomor Kotorri nga Përmeti i Shqipërisë, me motivacionin: “Për merita të veçanta në ruajtjen e afirmimin e kulturës kombëtare shqiptare”. Në kuadër të këtij aktiviteti, nga Shkolla e Mesme e Ulët e Muzikës “Faik Sylka”, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, është organizuar edhe një pike artistike nga orkestra e kësaj shkolle. Pas përfundimit të ceremonisë së ndarjes së çmimit, kryetari i komunës, Smajl Latifi i shoqëruar edhe nga kryetarja e Bashkisë së Permetit Alma Hoxha, Tomor Kotorri si dhe të pranishëm tjerë, kanë bërë homazhe dhe nderime për të rënë të lirisë

Vazhdojnë aktivitetet e Klubit të Librit, projekt ky i implementuar nga Drejtoria për Kulturë, dhe Sport.

- Përmes këtij projekti, synohet nxitja e lexueshmëris dhe krijimi i shprehis tek fëmijët dhe të rinjtë e komunës së Rahovecit.
- Poashtu, këto klube për lexim do të ndikojnë në nxitjen e të menduarit kritik, nxitjen e krijimtarisë, dhe rritjen e kreativitetit, nxitjen e socializimit të fëmijëve ndërmjet njëri tjetrit, nxitjen e aftësive debatuuese, si dhe rritjen e aftësive debatuuese

Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi"

- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit

Gjatë kësaj periudhe, kemi bashkëpunuar me dashamirë të librit: mësimdhënës, nxënës, shkrimtarë të komunës sonë, në mënyrë që të kemi ngritje të vetëdijës rreth lexueshmërisë. Biblioteka në tërësi ka ruajtur vazhdimësinë e punës së saj profesionale në shërbim të lexuesve, të atyre përdoruesve që kanë pasur nevoja për shërbime të ndryshme, si në kërkim të librit, në shfrytëzim të sallës dhe shërbimeve të tjera.

Aktivitetet për periudhën raportuese:

- Me datë 05.01.2021 Profesor Fetah Berisha e pasuroi bibliotekën me 3 ekzemplar të ri, poezi me titull: Mall e Dhembje.
- Me datë 14.01.2021 Drejtori i shkollës 12 Maji në Ratkoc, Hasan Krasniqi pasuroi bibliotekën me 14 ekzemplar.
- Me datë 18.01.2021 Profesor Milazim Bajraj e pasuroi bibliotekën me 3 ekzemplar të ri, poezi me titull: Lexo mesazhin tim.
- Me datë 01.03.2021 Selim Vefa e pasuroi bibliotekën me 3 ekzemplar.
- Me datë 03.03.2021 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec ka pasuruar fondin e saj librar me 210 tituj të rinj të librave, kjo u mundësua me përkrahjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), në një ceremoni tashmë tradicionale që ministria organizon çdo vit.
- Me datë 17.03.2021, duke pasur parasysh nevojën e ngritjes së lexueshmërisë në vendin tonë, komuna e Rahovecit ka paraparë hapjen e disa degëve të Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi", duke i mundësuar lexuesëve qasje në ambiente sa më të afërta për përfitim të njohurive dhe informacioneve të reja. Prandaj, rreth 601 ekzemplar me libra janë dërguar në Ratkoc, ku shumë shpejt pritet të aktivizohet edhe dega e tretë e bibliotekave, në kuadër të hapësirës së Shtëpisë së Kulturës "Jah Hoti".
- Me datë 25.03.2021 Biblioteka Komunale "Sulejman Krasniqi", u pasurua edhe me tri tituj të rinj librash nga poeti Hazir Luta i cili dhuroi bibliotekës 64 ekzemplar me libra. Për botimin e këtyre titujve, Komuna e Rahovecit, konkretisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe

Sport ka vazhduar përkrahjen për botim të librave, e në vazhdimësi Biblioteka "Sulejman Krasniqi" po pasurohet me tituj të rinj librash.

Pasurimi i fondit librar: 317 ekzemplar janar-mars.

Fondi total i librave në bibliotekë: 19070 ekzemplar.

Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar: 151 përdorues.

Palestra e Sportit "Mizair Isma"

Gjatë tre muajorit të parë, në palestër janë realizuar aktivitete të shumta sportive, si nga klube të Komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga ata ndërkombëtare, ndër aktivitete tjera janë:

Aktivitetet për muajin janar:

- Me datën 09.01.2021 është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketboll nërmjet dy ekipeve
- KB - Rahoveci dhe KB - Ylli
- Me datën 16.01.2021 është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketboll ndërmjet dy ekipeve
- KB-Rahoveci dhe KB-Vllaznimi.
- Me datën 14.01.2021 kanë filluar stërvitjet e Klubi të Hendbollit në Palester.
- Me datën 20.01.2021 kanë filluar stërvitjet e Klubi të Futsallit KFS-Rahoveci.
- Me datën 20.01.2021 kanë filluar stërvitjet e Klubi I Futsallit KFS-Rahoveci 2019.
- ME datën 23.01.2021 është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketboll nërmjet dy ekipeve
- KB-Rahoveci dhe KB-Prishtina.

Aktivitetet për muajin shkurt:

- Me datën 12.01.2021 është zhvilluar ndeshja për kup në futsal ndërmjet dy ekipeve KFS-Rahoveci 2019 dhe KFS-Liburni (Gjakove).
- Me datën 21.02.2021 është zhvilluar ndeshja kampionale ne Hendboll ndërmjet KH-Rahoveci dhe KH-Lepenci (Kaçanik).
- Me datën 24.02.2021 është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketboll ndërmjet dy ekipeve
- KB-Rahoveci dhe KB-Trepça (Mitrovice).

Aktivitetet për muajin mars:

- Me datën 06.03.2021 është zhvilluar ndeshja në Hendboll ndërmjet KH-Rahoveci dhe KH-Drita (Gjilan).
- Me datën 08.03.2021 është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketboll ndërmjet KB-Rahovci dhe KB-Vushtrria për Grupmosha U-18.
- Me datën 13.03.2021 është zhvilluar ndeshja në Futsall nërmjet dy ekipeve KFS-Rahoveci dhe KFS-Mitrovica.

- Me datën 14.03.2021 është zhvilluar ndeshja kampionale në Basketboll nërmjet dy ekipeve KB-Rahoveci dhe KB-Peja.
- Me datën 17.03.2021 janë zhvilluar garat regjionale në Basketboll, e organizuar nga Shoqata e Pedagoqeve të Kultures Fizike.
- Me datën 20.03.2021 është zhvillua ndeshja kampionale në Fusall ndërmjet dy ekipeve KFS-Rahoveci 2019 dhe KFS-Fahri Vraniqi (Gjakove).
- Me datën 20.03.2021 është zhvilluar ndeshja Kampionale në Hendboll ndërmjet dy ekipeve KH-Rahoveci vs KH-Deqani.

Përpos këtyre ndeshjeve, janë zhvilluar edhe plot aktivitete të tjera të përditëshme, të cilat janë mbajtur në palestër, janë mbajtur stërvitjet të rregullta të klubeve, janë zhvilluar ndeshjet miqësore, janë mbajtur aktivitetet nga OJQ - të ndryshme nga Komuna e Rakovecit etj.

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Në bazë të planit vjetor të punës për vitin kalendarik 2021, sipas dinamikës së punëve DPI ka zbatuar të gjitha ligjet përkatëse, sipas specifikave të lëmive të inspektorëve: tregtisë, sanitarisë, veterinarisë, ndërtimtarisë, pronësisë, komunikacionit dhe të mjedisit, për këtë periudhë raportuese.

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

INSPEKTORI I TREGUT

Gjatë periudhës janar-mars, inspektorët e tregut kanë kryer:

Inspektime	Aktvendime	Proceverbale	Pëlqime pune	Kontroll i rregullt
128	3	71	6	1

Krahas prioriteteve siç janë: Eliminimi i konkurrencës së padrejtë tregtare, mbrojtja e hapësirave publike, krijimi i një mjedisi të pastër, parandalimi i ndërtimeve ilegale, informimi i qytetarëve për domosdoshmërinë e pajisjes me leje të ndryshme që lëshohen nga komuna, e prioriteti dhe fokusi ynë kryesor ka qenë mbrojtja e shëndetit të qytetarëve, për ç'arsye janë zhvilluar aksione të vazhdueshme në terren për largim të mallrave ushqimore të cilësuar si të rrezikshme për shëndetin e qytetarëve.

INSPEKTORI I NDËRTIMIT

Gjatë periudhës janar-mars, inspektorët e ndërtimit kanë kryer:

Inspektime	Aktvendime	Njoftime	Fletëparaqitje	Gjoba mandatore
76	28	14	2	1

Në këtë periudhë raportuese ne kemi qenë vazhdimisht në vëzhgim të terrenit, gjatë kontrollimeve kemi verifikuar objektet të cilat nuk posedojnë leje ndërtimi dhe janë marrur masat paraprake të parapara me ligjet e ndërtimit dhe rregulloret në fuqi

INSPEKTORI SANITAR

Gjatë periudhës janar-mars, inspektori sanitar ka kryer:

Inspektime	Pëlqime sanitare
117	2

Në fushën e gastronomisë bazuar në raportet nga terreni, gjendja e përgjithshme higjieno- sanitare e restoranteve, gjelltove, fast- foodeve të ndryshëm në komunën e Rahovecit është në nivelin mesatar, me IKSHPK-në kemi pasur bashkëpunim të vazhdueshëm në lëminë e sanitarisë. Është realizuar kontrolli i përbashkët me inspektorë të AUV-së, në objektet e prodhimit të materialeve që vijnë në kontakte me ushqimin si dhe fabrikat për përpunimin dhe konservimin e pemëve dhe perimeve në komunën tonë.

INSPEKTORI VETERINAR

Gjatë periudhës janar-mars, inspektori veterinar ka kryer:

Inspektime	Asgjësime
151	44 gjedhe të sëmura nga TBC

Gjatë kësaj periudhe raportuese në vazhdimësi kemi bërë kontrollimin e mishtove dhe thertoreve, ku, prodhuesit e mishit i kemi urdhëruar që të pajisin të gjithë punëtorët me librezë sanitare. Me vendim të AUV-së gjatë muajit shkurt është bërë asgjësimi i 44 gjedheve të sëmurara nga TBC- (37 copa në fshatin Krushë e Madhe dhe 7 copë në fshatin Dejnë) nën përcjelljen e inspektoreve të veterinarisë dhe inspektorëve të AUV, janë propozuar në afërsi të gropës septike ekzistuese.

INSPEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Gjatë periudhës janar-mars, inspektori i komunikacionit ka kryer:

Inspektime	Urdhëresa
79	9

Në fushën e transportit publik, në vazhdimësi kemi përcjellë nga afër punën e kompanive të licencuara të autobusëve, të cilat janë duke i mbuluar mjaftueshëm dhe sigurt linjat e transportit të udhëtarëve.

INSPEKTORI I BUJQËSISË

Gjatë periudhës janar-mars, inspektori i bujqësisë ka kryer:

Inspektime	Procesverbale
65	65

Gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar inspektimi për ruajtjen e tokës bujqësore nga degradimet joligjore dhe inspektimi i barnatoreve veterinare dhe bujqësore.

INSPEKTORI I PYLLTARISË DHE MBROJTJES SË AMBIENTIT

Gjatë periudhës janar-mars, inspektori i pylltarisë dhe mbrojtjes së ambientit ka kryer:

Inspektime	Fletëparaqitje	Gjoha mandatore
70	2	3

Në tremujorin e parë të vitit 2021 kemi shpeshuar inspektimet për mbrojtjen e mjedisit, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së përgjithshme për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit dhe ndëshkimin e të gjithë atyre që qëllimshëm e dëmtojnë mjedisin dhe hapësirat publike.

- Drejtoria për Punë Inspektuese pas shpalljes së gjendjes emergjente nga Qeveria e Republikës së Kosovës si pasojë e pandemisë COVID-19 i ka zbatuar të gjitha urdhëresat si dhe vendimet e Kryetarit z. Smajl Latifi.
- Kemi vazhduar kujdestarinë jashtë orarit të rregullt të punës.
- Janë miratuar të gjitha lëndët në sistemin Sik gjatë tremujorit të parë.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

- Gjatë këtyre 3 muajve drejtori i DMSH-së ka qenë i angazhuar në menaxhim të kontratës për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, së bashku me kompanitë e kontraktuara nga komuna kanë qenë tërë kohën në terren, në çdo vendbanim të gjitha rrugët primare dhe sekondare janë pastruar me kohë dhe nuk është krijuara ndonjë problem në qarkullimin e lirë të automjeteve dhe këmbësorve;
- Në sektorin e zjarrfiksave në këtë 3 muaj kemi pasur një numër të madh të rasteve, 99 raste që kemi qenë në intervenim, pothuajse të gjitha rastet kanë qenë intervenim të lehta, vetëm një numër i vogël i tyre ishin intervenime të natyrës pak më të rëndë por që fatmirësisht nuk ka pasur viktima por vetëm ka pasur dëme materiale;
- Gjatë këtyre 3 muajve drejtori i DMSH-së ka qenë i angazhuar në menaxhimin e kontratës për mirëmbajtje të ndriçimit publik, gjatë këtij 3 muajri kemi arritur të intervenojmë në çdo vendbanim të komunës ku ka pasur probleme me ndriçim publik;
- Me datë 10-11 janar komuna jonë është përfshirë nga reshje të mëdha të shiut ku edhe kemi pasur vërshime dhe përmytje të mëdha në pjesën më të madhe të territorit të komunës sonë, i kemi mobilizuar të gjitha njësitet emergjente të komunës për të ju dal në ndihmë banorëve të prekur nga vërshimet, poashtu kemi pasur edhe evakuime të disa familjeve nga shtëpitë e tyre për shkak të rrezikut të madh nga vërshimet;

- Janë inspektuar lumenjtë, përockat dhe kanalet e hapura dhe pas inqizimit të gjendjes në terren i kemi propozuar drejtorive përkatëse për trajtim të kanaleve të bllokuara, pastrim të përockave etj.
- Është bërë regjistrimi i mjeteve teknike të nevojshme për intervenime në raste Emergjente dhe poashtu janë bërë të gjitha përgaditjet për sezonën e nxehtë të verës;
- Është bërë inspektimi i rregullt i objekteve publike dhe inspektimi i objekteve ekonomike dhe private në lidhje me paisjen e tyre me mjete mbrojtëse kundër zjarrit.

PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Raporti i punës për tremujorin e parë të vitit 2021, është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë.

Jemi të vetëdijshëm për synimet që i kemi vu vetes, dhe qytetarët e Komunës së Rahovecit presin me të drejtë nga ne. Kur kemi shpalosur programin tonë qeverisës, dhe vizionin tonë për Rahovecin, në fillim na është thënë se është ambicioz dhe vështirë i arritshëm, por për më shumë se dy vite qeverisje të gjithë së bashku jemi dëshmitarë se vizioni ynë për Rahovecin po jetësohet.

Bashkërisht me ekipin tim qeverisës, kemi gatishmërinë, energjinë dhe diturinë, të gjitha këto të vëna në dispozicion të qytetarëve, që Komuna e Rahovecit të ofrojë shërbime sa më cilësore.

Të vendosur për menaxhim të mirë të pronës publike, duke krijuar kushte më të mira për: zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, bujqësi, infrastrukturë, do të angazhohemi edhe më tutje të punojmë në të mirën e të gjithëve pa dallim.

Ju faleminderit!

Rahovec, prill 2021

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës së Rahovecit

